



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Digital
Inclusion
Initiative

Iniciativa për Përfshirje Digjitale

Raporti kombëtar **PËR KOSOVËN**



Botues

Qendra për Arsim e Kosovës/ Kosova Education Center (KEC)
Kompleksi i Shkollës "Mileniumi i Tretë"
Rruga "Qëndresa", nr. 48, Matiçan, Prishtinë, Kosovë
www.kec-ks.org

Për botuesin

Petrit Tahiri

Autor

Dukagjin Pupovci

Ekipi Mbështetës i KEC:

Hana Zylfiu-Haziri
Kërkesë Zogjani
Fjolla Xharra Bejtullahu

Përkthimi nga gjuha angleze

Translation Centre

Prishtinë, qershor 2025



**Financuar nga
Bashkimi Evropian**

Ky botim u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian Përgjegjësinë për përmbajtjen e tij e mban vetëm autori dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërih pikëpamjet e Bashkimit Evropian



**Centar za obrazovne politike
Centre for Education Policy**



**MACEDONIAN
CIVIC
EDUCATION
CENTER**




PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	5
HYRJE	7
1. KONCEPTUALIZIMI I PËRFSHIRJES DIGJITALE	9
2. KONTEKSTI KOMBËTAR PËR PËRFSHIRJEN DIGJITALE	11
2.1. Të dhëna të përgjithshme kontekstuale	11
2.2. Të dhënat në lidhje me aftësitë dhe shprehitë digjitale në përdorimin e teknologjive digjitale	12
2.3. Përmbledhje e kornizës përkatëse strategjike-legjislative	14
2.4. Qeverisja	16
2.5. Financimi i politikave për përfshirje digjitale	16
2.6. Harmonizimi ndërmjet legjislacionit të BE-së dhe atij kombëtar (analiza e dallimeve)	17
2.7. Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit për politikat e rëndësishme	18
3. SEKTORËT KYÇ - ROLI DHE KONTRIBUTI NË PËRFSHIRJEN DIGJITALE	19
3.1. Bashkëpunimi ndërsektorial	19
3.2. Kontributi i sektorëve specifikë	19
3.3. Roli i sektorit të shoqërisë civile dhe iniciativave të udhëhequra nga OSHC-të	21
3.4. Konkluzion i përgjithshëm mbi bashkëpunimin ndërsektorial	22
4. HULUMTIMET RELEVANTE MBI TEMËN E PËRFSHIRJES DIGJITALE	23
4.1. Vështrim i përgjithshëm mbi rezultatet e hulumtimit	23
4.2. Përmbledhje e gjetjeve të hulumtimeve	28
5. SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE KOMBËTARE	30
5.1. Identifikimi dhe përshkrimi i tri nismave/projekteve më efektive të udhëhequra nga qeveria ose sektori civil	30
5.2. Identifikimi dhe përshkrimi i shkurtër i nismave/projekteve të tjera që kishin potencial, por u përballën me sfida.	31
6. SFIDA KRYESORE DHE FUSHAT PËR PËRMIRËSIM	33
6.1. Sfidat në sigurimin e përfshirjes digjitale	33

6.2. Fushat për përmirësim	34
7. REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIM TË POLITIKAVE	36
7.1. Rekomandimet që kanë të bëjnë me popullsinë e përgjithshme	36
7.2. Rekomandimet në lidhje me grupet e cenueshme që janë në rrezik të përjashtimit digjital	37
REFERENCAT	39
SHTOJCA 1. FINANCIMI I POLITIKAVE PËR PËRFSHIRJE DIGJITALE	42
SHTOJCA 2. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE TË HULUMTIMIT	44
SHTOJCA 3. INICIATIVA TË ZGJEDHURA PËR PËRFSHIRJEN DIGJITALE	49
SHTOJCA 4. LISTA E PALËVE TË INTERESUARA QË JANË KONSULTUAR	51

LISTA E SHKURTESAVE

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional	KJO	Agjenda Digjitale e Kosovës
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	KODI	Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës	KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut sh.a
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	KREN	Rrjeti i Kosovës për Hulumtim dhe Edukim
BB	Ballkani Perëndimor	MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
BE	Bashkimi Evropian	NVM	Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme
BPV	Bruto Prodhimi Vendor	ODK	Open Data Kosovo
CIL	Aftësitë kompjuterike dhe informatike	OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
CSA	Agjencia e Sigurisë Kibernetike	RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
DESI	Indeksi i Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale	STIKK	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës
DII	Iniciativa për Përfshirje Digjitale	SHPIK	Shoqata Profesionale e Informaticientëve të Kosovës
EdTech	Teknologjia Arsimore	TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
eID	Identifikimi Elektronik	UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
eIDAS	Identifikimi Elektronik, Autentifikimi dhe Shërbimet e Besueshmërisë	UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
ICILS	Studimi Ndërkombëtar për Aftësitë Kompjuterike dhe Informatike	VHCN	Rrjet me Kapacitet Shumë të Lartë
ICK	Qendra e Inovacionit të Kosovës	VoRAE	Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve		
KCDE	Qendra e Kosovës për Arsim Digjital		
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës		
KFOS	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur		





HYRJE

Ky raport kombëtar është hartuar në kuadër të projektit “Iniciativa për Përfshirje Digjitale” (DI1), një projekt rajonal i realizuar në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Serbi, i financuar nga Komisioni Evropian. Qëllimi i këtij projekti është të rrisë rolin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) nga Ballkani Perëndimor për avokimin për demokracitë pjesëmarrëse dhe procesin e anëtarësimit në BE duke forcuar kapacitetet e tyre për zhvillimin e politikave dhe avokimin për përfshirjen digjitale.

Të dhënat dhe informacionet e paraqitura në këtë raport kombëtar janë mbledhur përmes një pyetësoi mbi politikën që është plotësuar pas analizës së dokumenteve të politikave të digjitalizimit dhe përfshirjes digjitale. Konsultimet me institucionet përkatëse, ekspertët, përdoruesit e shërbimeve digjitale, anëtarët e grupeve të cënueshme dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe me grupet e fokusit, janë përdorur për të përplotësuar hulumtimin e dokumentacionit dhe për të marrë perspektivën e palëve të interesuara mbi çështjet që lidhen me barazinë në procesin e digjitalizimit, si dhe për të formuluar rekomandime për përmirësimin e politikave. Lista e palëve të interesuara që janë konsultuar është dhënë në Shtojcën 4.

1 www.diiproject.net



1. KONCEPTUALIZIMI I PËRFSHIRJES DIGJITALE

Përfshirja digjitale në Kosovë është një koncept kompleks dhe evolutiv, i formësuar nga kornizat strategjike kombëtare, zhvillimet legjislativë dhe perceptimet e palëve të interesuara. Ndonëse nuk ka përkufizim specifik të përfshirjes digjitale në kornizën strategjike dhe legjislativë të Kosovës, vetë termi përmendet në dy dokumente të rëndësishme strategjike kombëtare:

- Agjenda Digjitale e Kosovës 2030, një agjendë horizontale ndërsektoriale që përcakton politikën dhe prioritetet e Kosovës në kontekstin e transformimit të vazhdueshëm digjital të ekonomisë dhe shoqërisë, i referohet “përfshirjes digjitale” në kontekst të avancimit të digjitalizimit të shërbimeve shtetërore përmes iniciativave për qeverisje elektronike (e-qeverisja) dhe tregtisë elektronike (e-tregtia), duke përmirësuar aftësitë digjitale të qytetarëve dhe të mësimin gjatë gjithë jetës, dhe duke nxitur partneritetet publiko-private në përputhje me politikën evoluese të BE-së. (Qeveria e Kosovës, 2023a).
- Në Agjendën e Reformave të Kosovës në kuadër të Instrumentit të BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor, përfshirja digjitale përmendet si një rezultat kyç i investimeve të planifikuara në infrastrukturën digjitale (Qeveria e Kosovës, 2024).

Politikat kombëtare në Kosovë i referohen përfshirjes digjitale në përgjithësi, duke theksuar objektivat e përgjithshme që lidhen me infrastrukturën dhe transformimin digjital në vend se të përcaktojnë dimensione ose grupe specifike. Aktet legjislativë dhe strategjike të Kosovës **e pranojnë rëndësinë e përfshirjes, por nuk i përcaktojnë saktësisht grupet e cënueshme ose në rrezik** përtej referencave të gjera. Në nivel kombëtar, theksi i masave të transformimit digjital vihet kryesisht në përmirësimet e përgjithshme në infrastrukturën digjitale dhe ndërtimin e kapaciteteve, duke lënë një boshllëk në politikën e përshtatura që adresojnë sfidat unike me të cilat përballen komunitetet e marginalizuara, siç janë ato në zonat rurale ose me resurse të kufizuara socioekonomike.

Palët e interesuara të intervistuar gjatë mbledhjes së të dhënave në terren ofruan një kuptim më të gjerë dhe më të nuancuar të përfshirjes digjitale, duke theksuar se kjo çështje shkon përtej qasjes së thjeshtë në infrastrukturën digjitale. Bashkëbiseduesit kyç identifikuan disa grupe të cënueshme të cilat shpesh janë në rrezik të përjashtimit digjital, veçanërisht komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe njerëzit nga zonat rurale dhe ata me kushte të pafavorshme socioekonomike (intervista me përfaqësues të VoRAE, HANDIKOS, KFOS dhe UNICEF; grupet e fokusit me nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë, si dhe me stafin arsimor).

Të intervistuarit theksuan pengesat praktike, siç janë disponueshmëria e kufizuar e pajisjeve digjitale, aftësitë e pamjaftueshme digjitale në mesin e të rriturve dhe përdoruesve të moshuar, dhe mbështetja e pam-

jaftueshme institucionale për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe mungesën e ndërfaqeve digjitale të qasshme dhe teknologjive ndihmëse (intervista me përfaqësuesin e HANDIKOS). Disa shembuj specifikë të cituar përfshinin komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që kishin vështirësi në disa procese bazike online, siç është regjistrimi për subvencione të arsimit ose për ndihmë sociale përmes platformave të qeverisjes elektronike, shpesh për shkak të proceseve të ndërlikuara të autentifikimit (grupi i fokusit me studentët romë, ashkali dhe egjiptianë). Përveç kësaj, nxënësit nga zonat rurale përballen me sfida për shkak të mungesës së lidhjes së qëndrueshme të internetit dhe pajisjeve të vjetruara në shkolla, duke kufizuar ndjeshëm mundësitë e tyre arsimore (intervista me përfaqësuesin e UNICEF-it).

Palët e interesuara theksuan në mënyrë të vazhdueshme mangësitë në hartimin dhe zbatimin e politikave të digjitalizimit, duke shprehur shqetësimin se iniciativat aktuale nuk i adresojnë mjaftueshëm nevojat unike të grupeve të marginalizuara, duke forcuar pabarazitë ekzistuese në vend që t'i zvogëlojnë. Palët e interesuara institucionale pranuan problemet që lidhen me koordinimin e fragmentuar ndërmjet agjencive publike, të cilat rezultojnë në projekte digjitale të vonuara ose të paplota dhe në shënjestrimin e pamjaftueshëm të iniciativave për zhvillimin e aftësive digjitale (intervista me përfaqësues të ASHI-së, Ministrisë së Ekonomisë dhe Zyrës së Kryeministrit).



2. KONTEKSTI KOMBËTAR PËR PËRFSHIRJEN DIGJITALE

2.1. Të dhëna të përgjithshme kontekstuale

Konteksti aktual ekonomik dhe socio-demografik i Kosovës karakterizohet me një zhvillim të moderuar ekonomik, i reflektuar në një BPV prej 9.65 miliardë eurosh në vitin 2023. Paga mesatare mujore prej 639 eurosh është në kontrast me shkallën e papunësisë prej

10.9%, e cila ka pësuar rënie të shpejtë në dy vitet e fundit, kryesisht për shkak të plakjes së popullsisë dhe migrimit. Analfabetizmi mbetet relativisht i ulët në 2.27%, ndërsa rreth 17% e popullsisë së moshës 10 vjeç e lart kanë kualifikime të larta arsimore. Gjendja e vështirë socio-ekonomike vazhdon të jetë e pranishme, me 21.4% të popullsisë që vazhdon të jetë në rrezik të varfërisë dhe përjashtimit social. Në aspektin demografik, të moshuarit (65 vjeç e më lartë) përbëjnë 10.97% të popullsisë dhe gati gjysma e popullsisë banon në zona rurale.

Tabela 1. Të dhëna kontekstuale lidhur me zhvillimin ekonomik të vendit, statusin socio-ekonomik dhe demografinë

Nr.	Treguesi	Vlera	Viti i të dhënave	Shënimet
1.	Bruto Prodhimi Vendor (BPV)	9,652.89 milionë.	2023	KASH 2025-2027, f. 37. (Ministria e Financave, 2024)
2.	Paga mesatare ose të ardhurat familjare të shprehura në EUR	€ 639	2024	Baza e të dhënave të ASK-së - https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/
3.	Shkalla e papunësisë	10.9%	2024	Baza e të dhënave të ASK-së - https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/
4.	% e popullsisë që kanë përfunduar arsimin fillor ose të mesëm të ulët	42.17%	2024	Popullsia e moshës 10 vjeç e më lart (Burimi: Regjistrimi i popullsisë 2024)
5.	% e popullsisë që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë	34.97%	2024	Popullsia e moshës 10 vjeç e më lart (Burimi: Regjistrimi i popullsisë 2024)
6.	% e popullsisë që kanë përfunduar arsimin e lartë	17.17%	2024	Popullsia e moshës 10 vjeç e më lart (Burimi: Regjistrimi i popullsisë 2024)
7.	% e popullsisë analfabete	2.27%	2024	Popullsia e moshës 10 vjeç e më lart (Burimi: Regjistrimi i popullsisë 2024)
8.	% e popullsisë në rrezik të varfërisë dhe përjashtimit social	19.5%	2023	Përmbledhje mbi Varfërinë dhe Barazinë në Kosovë 2025 (Banka Botërore, 2025)
9.	% e popullsisë mbi 65 vjeç	10.97%	2024	173,875 prej 1,585,566 (Burimi: Regjistrimi i popullsisë 2024)
10.	% e popullsisë në zonat rurale	49.82%	2024	789,939 prej 1,585,566 (Burimi: Regjistrimi i popullsisë 2024)

2.2. Të dhënat në lidhje me aftësitë dhe shprehinë digjitale në përdorimin e teknologjive digjitale²

Në Kosovë ka një përdorim (penetrim) të lartë të internetit, pasi rreth 99% të popullsisë e përdor atë në mënyrë të rregullt, me dallime minimale ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Megjithatë, ende vazhdon të ketë dallime të konsiderueshme në përdorimin e tij ndërmjet grupeve specifike, veçanërisht të rriturve më të moshuar (65-74 vjeç), prej të cilëve vetëm rreth 91.8% e përdorin internetin, dhe atyre me arsim minimal, ku përdorimi bie në 76%. Pavarësisht qasjes së gjerë në pajisje mobile (rreth 95% përdorim të telefonave të mençur), ndërveprimi me shërbimet e qeverisjes elektronike (e-qeverisjes) është dukshëm më i ulët, rreth 69%, veçanërisht te të moshuarit (24.4%) dhe pensionistët (22.1%). Shkalla e lartë e përdorimit të rrjeteve sociale (94%) është në kontrast të dukshëm me nivelin relativisht të ulët të aftësive digjitale, ku vetëm 28% zotërojnë aftësi bazike dhe vetëm 14% demonstron njohuri mbi nivelin bazik, duke nxjerrë në pah një hendek të madh ndërmjet qasjes së përgjithshme në internet dhe aftësive digjitale efektive.

Informacionet nga të dhënat e mbledhura në terren nënvizojnë këto mangësi, duke zbuluar se të rriturit më të shtyrë në moshë dhe personat me arsim të ulët shpesh hasin në sfida praktike në platformat digjitale,

2 Treguesit e ashtuquajtur DESI të përdorur nga Komisioni Evropian, i cili është përgjegjës për monitorimin e progresit digjital të shteteve anëtare të BE-së, janë përzgjedhur për këto qëllime.

veçanërisht kur kanë të bëjnë me shërbimet e qeverisjes elektronike. Palët e interesuara theksuan kompleksitetin e ndërfaqeve, vështirësitë në menaxhimin e fjalëkalimeve dhe mbështetjen e pamjaftueshme institucionale si pengesa kryesore. Për shembull, studentët romë, ashkali dhe egjiptianë theksuan vështirësitë në përdorimin e platformave si eKosova, veçanërisht në lidhje me rikuperimin e fjalëkalimit dhe joefikasitetin administrativ (grupi i fokusit me studentët romë, ashkali dhe egjiptianë). Përfaqësuesit nga HANDIKOSI theksuan se personat me aftësi të kufizuara përballen me kufizime të mëdha për shkak të shërbimeve digjitale në të cilat nuk po mund të kenë qasje dhe kostot e larta të teknologjisë ndihmëse, të cilat mbeten të paarrtshme për shumicën e personave që kanë nevojë për to (Intervistë me Menaxherin e Projekteve në HANDIKOS). Përveç kësaj, profesionistët e arsimit vazhdimisht kanë vërejtur mungesë të infrastrukturës digjitale brenda shkollave, mbështetje teknike të pamjaftueshme dhe mundësi të kufizuara të trajnimit për mësimdhënësit, duke përkeqësuar edhe më shumë problemet e edukimit digjital të popullatave rurale dhe të margjinalizuara (grupi i fokusit me stafin arsimor). Në përgjithësi, palët e interesuara theksuan nevojën e madhe për mekanizma mbështetës të përshtatur, siç janë qendrat e dedikuara të ndihmës, ndërfaqet e thjeshtësuara të parapara posaçërisht për përdoruesit e moshuar dhe ata me aftësi të kufizuara, dhe seancat e trajnimit proaktiv të përshtatura në mënyrë të veçantë për të rritur kompetencat digjitale të popullsisë të cenueshme.

Tabela 2. Treguesit për monitorimin e përfshirjes digjitale - popullsia

Nr.	Treguesi	Grupet e popullsisë						Nëse ka të dhëna për grupe të tjera të cenueshme, ju lutem shtoni ato	Shënime
		Meshkuj	Femra	Të moshuarit (65-74 vjeç)	Arsimimi (më pak se shkolla e mesme)	Të papunët	Popullsia e përgjithshme		
1.	% e popullsisë që përdor internetin	98.64%	99.29%	91.77%	Arsim fillor: 89% Më pak se arsimi fillor: 76% (STIKK, 2019)	99.49%	98.97%	Amviset: 98.74% Pensionistët: 90.16%	(UNDP, 2025)
2.	% e popullsisë që përdor shërbimet e e-qeverisjes	70.89%	67.45%	24.37%		76.39%	69.17%	Amviset: 54.14% Pensionistët: 22.06%	(UNDP, 2025)
3.	% e popullsisë që përdor në mënyrë aktive mediat sociale	94.50%	93.2%	74.24%		98.21%	93.85%	UNDP. Amviset: 95.38% Pensionistët: 74.10%	(UNDP, 2025)
4.	% e popullsisë me aftësi digjitale bazike, të ndërmjetme dhe të avancuara						Bazike 28% Më shumë se bazike: 14% (2019)		(RCC, 2022)
5.	% e popullsisë që përdor telefona të mençur ose pajisje të tjera mobile për qasje në internet	96.33%	95.39%	89.34%		91.40%	95.39%		(UNDP, 2025)

Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të detajuar të aftësive teknologjike specifike të popullsisë së Kosovës, duke ilustruar kompetenca digjitale të avancuara përgjithësisht të kufizuara, me aftësi dukshëm të ulëta për detyra komplekse si kodimi, menaxhimi i tabelave llogaritëse (spreadsheet) dhe redaktimi (editimi) multime-

dial - duke konfirmuar se është identifikuar një mungesë kritike e aftësive në treguesit në nivel të popullsisë së përgjithshme. Tabela paraqet shpërndarjen e personave të moshës 16–74 vjeç, të shprehur në përqindje, bazuar në aftësitë teknologjike dhe kompjuterike të ushtruara “gjatë tre muajve të fundit”.

Tabela 3. Aftësitë Teknologjike në përqindje 2021

	Shkrimi/ kodimi në një gjuhë programuese (SAS, SQL etj.)	Redaktimi i fotove, videove ose skedarë audio	Përdorimi i veçorive të përparuara të softuerit të tabelave llogaritëse (formula, funsione)	Përdorimi i programit të tabelave llogaritëse (në excel)	Krijimi i prezantimeve	Programet e përpunimit të tekstit (në word)	Ndryshimi i opsioneve të një softueri	Shkarkimi ose instalimi i softuerëve/ aplikacioneve	Kopjimi/ lëvizja e skedarëve/ dosjeve
2021	3.0	16.6	2.1	2.9	17.1	17.0	12.8	22.8	22.4

(Burimi: Baza e të dhënave të ASK-së)

2.3. Përmbledhje e kornizës përkatëse strategjike-legjislative

Kosova e ka zhvilluar një kornizë të fortë legjislative dhe strategjike që synon promovimin e transformimit dhe përfshirjes digjitale, e cila përfshinë disa ligje dhe dokumente të politikave që përcaktojnë drejtimin për përparimet digjitale. Përmbledhja e mëposhtme ofron një analizë të instrumenteve kryesore legjislative dhe strategjive kombëtare, duke vënë në pah objektivat e tyre kryesore dhe duke identifikuar mangësitë e cekura nga palët e interesuara në lidhje me zbatimin efektiv dhe praktikën gjithëpërfshirëse.

Ligji për Komunikimet Elektronike rregullon rrjetet dhe shërbimet e telekomunikacionit në Kosovë, duke promovuar konkurrencën në treg dhe duke siguruar shërbim universal. (RKS, 2012a). **Ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike** lehtëson shërbimet elektronike duke siguruar ekuivalencën e dokumenteve elektronike me dokumentet tradicionale, duke mbështetur transaksionet digjitale, pagesat elektronike dhe parandalimin e krimeve kibernetike (RKS, 2012b). **Ligji për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara** krijon një kornizë për identifikimin digji-

tal, nënshkrimet elektronike dhe transaksionet elektronike të sigurta, duke i përafëruar ato ngushtë me standardet e BE-së (RKS, 2021a). **Ligji për Uljen e Kostos së Shtrirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë** synon të mundësojë internetin me brez të gjerë të përballeshëm përmes infrastrukturës së përbashkët dhe procedurave të thjeshtësuara (RKS, 2021b). Ligji i kohëve të fundit **për Sigurinë Kibernetike** krijon mekanizma të fuqishëm për siguri kibernetike dhe qëndrueshmëri digjitale, duke krijuar Agjencinë e Sigurisë Kibernetike (ASK) si organ koordinues (RKS, 2023).

Përkundër mbulimit gjithëpërfshirës, palët e interesuara që morën pjesë në hulumtimin në terren **tregojnë se ende ka mangësi** të konsiderueshme. Zyrtarët publikë dhe përfaqësuesit e OSHC-ve theksuan se legjislacionit i mungon fokusi i mjaftueshëm në zhvillimin e aftësive digjitale dhe në mbështetjen e synuar për grupet e cenueshme, siç janë të moshuarit dhe komunitetet e marginalizuara të cilat përballen me sfida në qasjen dhe përdorimin efektiv të shërbimeve digjitale.

Ekzistojnë dy dokumente strategjike kyçe për transformimin digjital:

- **Agjenda Digjitale e Kosovës 2030** është një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse që synon transformimin e Kosovës në një shoqëri të përparuar në aspektin digjital deri në vitin 2030. Agjenda përcakton pesë objektiva strategjike: 1) Zhvillimi i infrastrukturës digjitale të avancuar dhe të sigurt; 2) Nxitja e transformimit digjital të bizneseve; 3) Digjitalizimi i shërbimeve publike; 4) Zhvillimi i një popullsie të aftë në aspektin digjital dhe një ekosistemi inovativ të kërkimit dhe zhvillimit; dhe 5) Krijimi i një ekosistemi të qëndrueshëm të sigurisë kibernetike. Buxheti total i vlerësuar për këtë agjendë është 152 milionë euro, 65% i financuar nga Buxheti i Shtetit dhe 35% nga kontributet e donatorëve (Qeveria e Kosovës, 2023a).
- **Strategjia e Kosovës për Qeverisje Elektronike 2023–2027** është një kornizë strategjike e hartuar për të përshpejtuar transformimin digjital të administratës publike në Kosovë, duke e përparuar me vizionin e Agjendës Digjitale të Kosovës 2030 për të krijuar një qeveri moderne digjitale të përqendruar tek qytetari. Ajo fokusohet në gjashtë objektiva strategjike: 1) Përmirësimi i koordinimit dhe menaxhimit të qeverisjes elektronike; 2) Rritja e kompetencave digjitale të zyrtarëve publikë; 3) Krijimi i një arkitekture të ndërmarrjes të unifikuar dhe të ndërveprueshme “të të gjithë qeverisë»; 4) Ofrimi i shërbimeve publike digjitale gjithëpërfshirëse dhe të përqendruara te përdoruesi; 5) Forcimi

i qëndrueshmërisë për siguri kibernetike; dhe 6) Nxitja e inovacionit përmes partneriteteve publiko-private. Ajo është paraparë të zbatohet gjatë një periudhe pesëvjeçare me një buxhet të përgjithshëm të vlerësuar prej afërsisht 48.46 milionë eurosh, i financuar përmes një kombini të Buxhetit të Shtetit dhe kontributeve të donatorëve (Qeveria e Kosovës, 2023b).

Të dy strategjitë përfshijnë masa kyçe që synojnë zgjerimin e qasjes në teknologjitë digjitale dhe përmirësimin e aftësive digjitale. Megjithatë, ndërsa strategjitë nxisin zhvillimin e infrastrukturës dhe rritjen e aftësive, ekziston një perceptim se fusha të caktuara - veçanërisht mbështetja e përshtatur për grupet e marginalizuara dhe komunitetet në zona të largëta - nuk mbulohen në mënyrë të mjaftueshme. Informacionet në terren tregojnë se palët e interesuara në përgjithësi i mbështesin objektivat e këtyre strategjive, por i nënvizojnë sfidat për zbatimin e tyre. Profesionistët e arsimit dhe përfaqësuesit e komunitetit theksuan se mbështetja praktike dhe iniciativat e përshtatura për grupet e marginalizuara, përfshirë popullsinë rurale, të moshuarit dhe ata me përgatitje të kufizuar arsimore janë të pamjaftueshme. Zyrtarët publikë e njohin nevojën për një koordinim më të mirë ndërmjet ministrive, udhëzime më të qarta të zbatimit, siç është përcaktimi i saktë i përgjegjësive institucionale dhe i afateve kohore për veprime specifike (si p.sh., prokurimi i pajisjeve arsimore dhe programet e trajnimit për aftësi digjitale), si dhe krijimi i mekanizmave më të fuqishëm mbështetës që përfshijnë një mbulim më të gjerë gjeografik, kohëzgjatje të qëndrueshme dhe metoda të ndryshme të realizimit (duke përfshirë

ndihmën e përshtatur për të moshuarit dhe popullsitë e marginalizuara) për të adresuar në mënyrë efektive mangësitë e vazhdueshme në përfshirjen digjitale.

2.4. Qeverisja

Digjitalizimi dhe teknologjitë digjitale në Kosovë janë kryesisht nën kompetencën e Ministrisë së Ekonomisë, e cila udhëheq sektorin e telekomunikacionit përmes Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (RKS, 2012a). Paralelisht me këtë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike është përgjegjëse për çuarjen përpara të iniciativave të qeverisjes elektronike, të menaxhuara përmes Agjencisë së saj vartëse për Shoqërinë e Informacionit (ASHI), e cila koordinon transformimin digjital në të gjitha institucionet publike (RKS, 2013), derisa Agjencia e Sigurisë Kibernetike - gjithashtu nën Ministrinë e Punëve të Brendshme - fokusohet në mbrojtjen e infrastrukturave digjitale (RKS, 2023). Për më tepër, korniza strategjike kërkon që të krijohet një komision i nivelit të lartë, i udhëhequr nga kryeministri dhe i përbërë nga përfaqësues të një game të gjerë të ministrive të qeverisë (përfshirë ministritë e ekonomisë, të arsimit, të punëve të brendshme, të drejtësisë, të financave, të pushtetit lokal, të shëndetësisë, të bujqësisë, të mjedisit, të tregtisë dhe të punëve të jashtme), të agjencive të specializuara rregullatore dhe ekzekutive dhe të ndërmarrjeve publike (si ARKEP, ASHI dhe KOSTT), si dhe të akademisë (përfaqësuar nga Universiteti i Prishtinës), për të koordinuar, zbatuar dhe monitoruar agjendën kombëtare të transformimit digjital, duke siguruar kështu një qasje gjithëpërfshirëse dhe

të integruar ndaj qasjes dhe përfshirjes digjitale (Qeveria e Kosovës, 2023a).

Megjithatë, të dhënat e mbledhura nga terreni tregojnë se zbatimi real i këtyre kornizave strategjike pengohet nga koordinimi i dobët ndërinstitucional, fondet e pamjaftueshme dhe mungesa e masave të përfshirjes të integruara në mënyrë sistematike. Zyrtarët publikë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile në mënyrë specifike shprehën shqetësime lidhur me përgjegjësitë e fragmentuara institucionale dhe bashkëpunimin e pamjaftueshëm ndërmjet ministrive, duke theksuar veçanërisht sfidat e vazhdueshme në harmonizimin e përpjekjeve për përfshirje digjitale. Palët e interesuara theksuan se këto probleme në koordinim kufizojnë ndjeshëm efektivitetin e politikave kombëtare që synojnë përfshirjen digjitale.

2.5. Financimi i politikave për përfshirje digjitale

Masat strategjike për përfshirjen digjitale në Kosovë janë mbështetur me investime të konsiderueshme, që kryesisht janë fokusuar në infrastrukturën e internetit me brez të gjerë, sigurinë kibernetike, shërbimet publike digjitale dhe teknologjinë arsimore. Investimet kryesore kombëtare përfshijnë projektin KODE (20.7 milionë euro), të financuar nga kredia e Bankës Botërore, e cila ka ndarë 18.6 milionë euro për të zgjeruar qasjen në internet me brez të gjerë dhe për trajnimin për aftësi digjitale në zonat rurale dhe të pambështetura sa duhet. Bashkimi Evropian, përmes Agjendës së Reformës së BE-së (40 milionë euro), mbështet iniciativat për infrastrukturë të internetit me brez të gjerë dhe siguri kibernetike të

avancuar, megjithëse brenda këtij totali nuk është specifikuar ndonjë buxhet i dedikuar për përfshirjen digjitale.

Në nivel vendi, Buxheti i Kosovës ka ndarë fonde nëpër sektorë të ndryshëm, me investime të konsiderueshme të drejtuara në Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit (23.7 milionë euro) për të përmirësuar infrastrukturën digjitale të shërbimit publik dhe sigurinë kibernetike. Përveç kësaj, Ministria e Arsimit ka ndarë 15 milionë euro të dedikuara për pajisje digjitale në arsimin parauniversitar, duke promovuar në mënyrë të drejtpërdrejt përfshirjen digjitale.

Hulumtimi në terren evidenton shqetësime sa i përket transparencës dhe efikasitetit të shpenzimeve, duke nënvizuar në veçanti mungesën e burimeve të qarta të financimit për grupet e cënueshme dhe për zhvillimin e aftësive digjitale. Palët e interesuara dhanë shembuj për vonesat dhe nën-shfrytëzimin e fondeve të alokuara në Ministrinë e Arsimit për prokurimin e pajisjeve digjitale, që kryesisht kishin mbetur të pashpenzuara, pavarësisht nevojave të identifikuara në nivel të shkollave. Për më tepër, është theksuar mbështetja e kufizuar e dedikuar për komunitetet e marginalizuara si romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, të cilët shpesh mbështeten gati krejtësisht në iniciativat e financuara nga donatorët në vend të financimit të vazhdueshëm qeveritar. Palët e interesuara theksuan nevojën për mekanizma më të mirë të përcjelljes dhe raportimit transparent për të siguruar që burimet e alokuara të arrijnë në mënyrë efektive te përfituesit e synuar dhe që ata të përfitojnë nga to.

(Shihni Shtojcën 1 për përmbledhje të detajuar mbi financimin).

2.6. Harmonizimi ndërmjet legjislacionit të BE-së dhe atij kombëtar (analiza e dallimeve)

Sipas Raporteve të Progresit të BE-së për vitet 2023 dhe 2024 për Kosovën, korniza strategjike-legjislative e vendit tregon një harmonizim të pjesshëm me Acquis të BE-së në sektorin e telekomunikacionit. Një progres i dukshëm është arritur në uljen e kostos së internetit me brez të gjerë dhe në zbatimin e programit pilot të qasjes në 5G. Megjithatë, ende mbeten mangësi të konsiderueshme - Kosova duhet ta harmonizojë plotësisht legjislacionin e saj me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike, Aktin e BE-së për Infrastrukturën Gigabit dhe Aktet për Shërbimet Digjitale dhe Tregjet Digjitale. Në sferën e shërbimeve publike digjitale, progresi i Kosovës është vlerësuar falë vënies në funksion të portalit e-Kosova dhe shkallën e lartë të mbulimit me internet me brez të gjerë, megjithatë vetëm një numër i vogël e shërbimeve publike ofrohet në mënyrë elektronike. Kërkoet një harmonizim i mëtejshëm me kornizat e BE-së për të dhënat e hapura, Kornizën Evropiane të Ndërveprimit dhe Aktin e Evropës së Ndërveprueshme. Agjenda e Reformës së Kosovës 2024–2027, e sponsorizuar nga BE-ja, parasheh një transformim digjital gjithëpërfshirës i cili integron infrastrukturën e avancuara të TIK-ut për të bërë përmirësime në ofrimin e shërbimeve publike, efikasitetin administrativ dhe konkurrueshmërinë e përgjithshme ekonomike. Iniciativat qendrore përfshijnë përmirësimin e rrjeteve të internetit me brez të gjerë dhe 5G, zbatimin e një sistemi të unifikuar të identitetit digjital dhe përmirësimin e operacioneve qeveritare

përmes platformave të ndërveprimit dhe parimit “vetëm një herë” (once-only). Këto masa kanë për qëllim të ulin barrën administrative, të nxisin inovacionin dhe të rrisin sigurinë kibernetike, me qëllim të krijimit të një sektori publik më të qëndrueshëm dhe të aftësuar në aspektin digjital në zonat urbane dhe rurale (Komisioni Evropian, 2023) (Komisioni Evropian, 2024a).

Sa i përket përfshirjes digjitale, Agjenda Digjitale thekson rritjen e disponueshmërisë së shërbimeve që ofrohen online dhe sigurimin e lidhjes së internetit me shpejtësi të lartë për të gjithë qytetarët dhe bizneset, duke ngushtuar kështu hendekun digjital ndërmjet rajoneve. Megjithatë, ndonëse korniza mbështet qasjen e gjerë në teknologjitë digjitale, ajo nuk synon në mënyrë konkrete përmirësimin e aftësive digjitale ose mbështetjen e përshtatur për grupet e cënueshme. Me fjalë të tjera, edhe pse bëhen përpjekje për të krijuar një ambient digjital më të qasshëm, ka një theks të kufizuar në ndërhyrjet e specializuara për të përmirësuar aftësitë teknologjike dhe edukimin digjital të popullsisë në rrezik ose të marginalizuara (Qeveria e Kosovës, 2024).

2.7. Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit për politikat e rëndësishme

Agjenda Digjitale e Kosovës 2030 dhe Strategjia e Qeverisjes Elektronike përfshijnë tregues të performancës që rishikohen dhe përditësohen në mënyrë periodike, duke mundësuar monitorimin e progresit drejt objektivave të tyre strategjike. Komisioni për Transformimin Digjital, i koordinuar nga Zyra e Kryeministrit, së bashku me min-

istritë përkatëse, veçanërisht Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e zhvillimeve brenda sektorëve digjitalë specifikë. Për më tepër, zbatimi i legjislacionit në lidhje me përfshirjen digjitale vlerësohet në mënyrë periodike nga Kuvendi i Kosovës, duke siguruar kështu mbikëqyrje parlamentare.

Megjithatë, hulumtimet në terren tregojnë se mekanizmat aktualë të monitorimit dhe vlerësimit përballen me mangësi kritike. Palët e interesuara nga institucione publike dhe shoqëria civile kanë shprehur shqetësime në lidhje me përshtatshmërinë dhe transparencën e kornizave ekzistuese të vlerësimit. Ata theksuan mungesën e raporteve të detajuara të monitorimit të disponueshme për publikun, duke nënvizuar mungesën e informacioneve të qarta dhe të qasshme mbi efektivitetin dhe ndikimet e politikave. Palët e interesuara theksuan domosdoshmërinë për një transparencë dhe llogaridhënie publike më të madhe, veçanërisht lidhur me rezultatet e synuara për grupet e cënueshme dhe komunitetet rurale. Për më tepër, është identifikuar nevoja për një mbledhje dhe analizë më sistematike të të dhënave për të matur ndikimet e prekshme të politikave digjitale, veçanërisht ato që adresojnë edukimin digjital dhe nevojat specifike të popullatave të marginalizuara.



3. SEKTORËT KYÇ - ROLI DHE KONTRIBUTI NË PËRFSHIRJEN DIGJITALE

3.1 Bashkëpunimi ndërsektorial

Agjenda Digjitale e Kosovës (ADK) 2030 parashikon bashkëpunimin e strukturuar ndërsektorial si thelbësor për zbatimin e saj, veçanërisht përmes një komisioni të nivelit të lartë të udhëhequr nga kryeministri dhe të përbërë nga përfaqësues prej të gjitha ministrive dhe agjencive përgjegjëse për objektiva strategjike specifike (Qeveria e Kosovës, 2023a). Ky komision ka për detyrë të koordinojë veprimet në të gjithë sektorët si infrastruktura, biznesi, shërbimet publike, arsimi dhe siguria kibernetike. Zbatimi është i decentralizuar, ku çdo objektivi u caktohet institucioneve përkatëse, duke siguruar harmonizim ndërministror. Përgjegjësitë e monitorimit dhe raportimit i takojnë Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë së Ekonomisë, që mbështeten nga raportet vjetore të progresit dhe nga dy vlerësime të jashtme. Ndonëse korniza mundëson një veprim të koordinuar, ADK 2030 nuk përmend në mënyrë

eksplicite programet ndërsektorale që u drejtohen popullsisë në rrezik nga përjashtimi digjital. Të dhënat nga terreni tregojnë se bashkëpunimi ndërsektorial, megjithëse i planifikuar, përballet me pengesa praktike për shkak të mandateve të paqarta, reagimit të kufizuar nga ministritë dhe veprimeve të fragmentuara, që ndikojnë veçanërisht te grupet e cenueshme.

3.2. Kontributi i sektorëve specifikë

Tabela e mëposhtme përmbledh progresin dhe mangësitë në digjitalizim në sektorët kyç publikë dhe të shërbimeve në Kosovë, bazuar në hulumtimet e dokumentacionit dhe intervistat në terren. Derisa disa sektorë kanë bërë hapa të matshëm në ofrimin e shërbimeve digjitale, integrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse, të qasshme dhe të përshtatura për popullatat e cenueshme mbetet i kufizuar. Shërbimet e veçanta për këto grupe janë ose minimale ose varen nga projekte sporadike të financuara nga donatorët, në vend se të përfshihen në mënyrë sistematike në strategjitë sektoriale ose të mbështeten përmes financimit të qëndrueshëm publik.



Tabela 4. Kontributi sektorial në përfshirjen digjitale në Kosovë

Sektori	A ka shërbime digjitale, nëse po, cilat?	A ka monitorim të cilësisë dhe kënaqësisë me këto shërbime? (P/J)	A ka shërbime të veçanta për grupet e cenushme, nëse po, cilat?	A janë identifikuar pengesa për grupet e cenushme lidhur me shërbimet digjitale, nëse po, cilat?
Arsimi	Po: portali eKosova (shërbimet për arsimin e lartë dhe mësimdhënësit); përdorim i kufizuar i platformave digjitale të të nxënit dhe teknologjive ndihmëse	Nuk ka monitorim sistematik	Të kufizuara dhe jo konsistente; kryesisht i financuara nga donatorët, ju mungon mbështetja kombëtare	Mungesë pajisjesh, trajnim i kufizuar, teknologji ndihmëse minimale
Telekomunikacioni	Po: Penetrim i lartë i internetit dhe atij mobil, ofrues të shumtë privatë të shërbimeve	Po (monitoruar nga ARKEP)	Nuk ka shërbime të posaçme sistematike; disa programe private të edukimit digjital	Investime të kufizuara në edukimin digjital; shqetësime se sa është i përballueshëm në zonat rurale
Shëndetësia	Të kufizuara: Numër i vogël shërbimesh elektronike përmes eKosova (përzgjedhja e mjekut familjar, rezultatet e analizave laboratorike); infrastruktura bazë e telemjekësisë	Nuk janë identifikuar raporte sistematike të monitorimit ose vlerësimit	Nuk ka veçori të qarta të qasjes	Shërbime digjitale të pazhvilluara, shkallë e ulët e përdorimit nga të moshuarit/grupet e marginalizuara
Shërbimet financiare	Po: E-banking, shërbime bankare mobile, pagesa elektronike, shërbime financiare në eKosova	Monitorohet brenda vet bankave, nuk ka raportime publike	Shërbime shumëgjuhëshe të disponueshme; qasja për personat me aftësi të kufizuara është e paqartë	Probleme me edukimin digjital, ndërfaqe të papërshtatshme për përdoruesit e moshuar dhe ata në zonat rurale
Mirëqenia sociale	Nuk ka shërbime të rëndësishme digjitale në dispozicion	N/A (nuk ka shërbime për të monitoruar)	N/A	Mungesa e çfarëdo qasjeje digjitale në shërbime
Hulumtimi dhe inovacioni	Nuk ka shërbime sistematike digjitale në dispozicion; përpjekje minimale për inovacion digjital	N/A	Nuk ka iniciativa sistematike që synojnë grupet e cenushme	Mungesa e fondeve, fokusi sistematik; bashkëpunimi sporadik mes akademisë dhe industrisë
Administrata	Po: Lëshim certifikatash (të gjendjes civile, pronësore), verifikim dokumentesh, licenca, përcjellje e lëndëve gjyqësore përmes portalit eKosova.	Monitorim i pjesshëm (i brendshëm, transparencë e kufizuar)	Shërbime në gjuhët zyrtare, qasje bazike; mungon mbështetja e përshtatur për personat me aftësi të kufizuara	Probleme me qasjen (rikuperimi i fjalëkalimit, procese të paqarta), nuk ka përkrahje proaktive
Ekonomia	Qendrat e Trajnimit Profesional ofrojnë trajnime për aftësi digjitale si pjesë e masave aktive të tregut të punës.	Nuk ka raportim të hollësishëm publik	Nuk ka programe të specializuara për grupet e cenushme; synim i kufizuar	Mungesë e shtrirjes dhe përshtatjes së trajnimit; pjesëmarrje e ulët nga popullatat e marginalizuara për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit ose parakushteve.

3.3. Roli i sektorit të shoqërisë civile dhe iniciativave të udhëhequra nga OSHC-të

Organizatata e shoqërisë civile (OSHC) në Kosovë janë bërë gjithnjë e më aktive në fushën e përfshirjes digjitale, duke zbatuar ndërhyrje të synuara që mbështesin grupet e marginalizuara, avokojnë për barazi digjitale dhe përplotësojnë përpjekjet publike përmes arsimit të bazuar në komunitet dhe zhvillimit të aftësive. Duke u bazuar si në hulumtimet në terren ashtu edhe në shqyrtimin e dokumentacionit, kontributi i OSHC-ve mund të kategorizohet në tri fusha kryesore: avancimi i edukimit digjital, adresimi i mangësive në qasje dhe promovimi i edukimit digjital gjithëpërfshirës.

Shoqata Profesioniste e Informaticientëve të Kosovës (SHPIK), është fokusuar në integrimin e kompetencave digjitale në kurrikulat shkollore dhe në përmirësimin e aftësive të mësimdhënësve në arsimin publik, shpesh duke plotësuar boshllëqet në përpjekjet e bëra nga shteti. Shoqata theksoi gjatë intervistimit se Ministria e Arsimit ka kapacitet të kufizuar për menaxhimin e inovacionit digjital dhe se përditësimet kurrikulare nuk kanë ecur me ritmin e përparimit teknologjik, përfshirë edhe integrimin e inteligjencës artificiale.

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) ka zbatuar nisma të shumta që synojnë promovimin e qasjes së barabartë në të nxënimit digjital. Këto përfshijnë projekte për forcimin e kompetencave digjitale të mësimdhënësve, zhvillimin e përmbajtjes digjitale gjithëpërfshirëse dhe fuqizimin e nxënësve për të fituar aftësi digjitale dhe për t'u angazhuar në mënyrë aktive në jetën qytetare. Organizata

ka punuar edhe për të përmirësuar përdorimin praktik të platformave të mësimin të kombinuar dhe ka mbështetur përfshirjen e komunitetit përmes klubeve të mentorimit.

Qendra Kosovare për Arsim Digjital (KCDE) i ka dhënë përparësi përfshirjes digjitale të të rinjve të marginalizuar, veçanërisht vajzave dhe grupeve minoritare. Përmes programeve të trajnimit në aftësitë digjitale dhe edukimit mediatik, si dhe duke shpërndarë pajisje gjatë pandemisë COVID-19, KCDE ka mbështetur pjesëmarrjen e nxënësve në pozitë të pafavorshme në arsim dhe në tregun e punës.

Organizata të tjera si **Open Data Kosovo (ODK)** dhe **Qendra e Inovacionit të Kosovës (ICK)** kontribuojnë duke nxitur sipërmarrjen digjitale dhe transparencën në qeverisje përmes aplikacione teknologjike që përdoren për qëllime qytetare dhe mbështetjes për bizneset fillestare të TIK-ut. Këta aktorë më shumë përqendrohen në transformimin sistematik dhe inovacion, duke përplotësuar përpjekjet arsimore në nivelin bazë.

Pavarësisht rolit të tyre proaktiv, përfaqësuesit e OSHC-ve kanë shprehur shqetësime në lidhje me natyrën e fragmentuar të politikave publike të përfshirjes digjitale dhe vëmendjen e pamjaftueshme që u kushtohet popullsisë të cënueshme, përfshirë banorët e zonave rurale, qytetarët e moshuar dhe pakicat etnike. Shumë OSHC e shohin rolin e tyre si thelbësor jo vetëm në ofrimin e shërbimeve, por edhe në avokim, pilotimin e modeleve të shkallëzuara dhe ofrimin e komenteve mbi boshllëqet në politika. Ndërkohë që financimi nga donatorët ka mundësuar një programim me ndikim, qëndrueshmëria e këtyre nismave vazhdon të varet nga një bashkëpunim

më i strukturuar me institucionet shtetërore dhe investimet publike afatgjata në barazinë digjitale.

3.4. Konkluzion i përgjithshëm mbi bashkëpunimin ndërsektorial

Bashkëpunimi ndërsektorial në Kosovë për të rritur përfshirjen digjitale mbetet i pazhvilluar sa duhet dhe i fragmentuar, pavarësisht ambicieve strategjike të përcaktuara në ADK 2030 dhe ekzistimit të një komisioni të nivelit të lartë për të koordinuar transformimin digjital. Edhe pse disa sektorë-arsimi, ekonomia, shëndetësia dhe shoqëria civile-po zbatojnë në mënyrë të pavarur iniciativa për të përmirësuar qasjen dhe kompetencat digjitale, këtyre përpjekjeve shpesh u mungon koordinimi dhe harmonizimi i ndërsjellë.

Intervistat në terren zbulojnë mangësi dhe perceptime të rëndësishme. Nga perspektiva e Zyrës së Kryeministrit, ndonëse bashkëpunimi ndërministror ekziston në teori, ai përshkruhet si “i pabarabartë dhe tejet i varur nga iniciativa e institucioneve individuale.” Palët e interesuara nga Ministria e Ekonomisë vunë në dukje përvojat pozitive të punës me sektorin e arsimit në projektin KODE, por po ashtu shprehën zhgënjimin për mungesën e reagimit nga Ministria e Arsimit, veçanërisht në lidhje me ndarjet e pashfrytëzuara buxhetore për pajisjet digjitale. SHPIK shprehu shqetësimet rreth qasjes së rezervuar, duke theksuar nevojën për një bashkëpunim më të fortë midis institucioneve publike, aktorëve të industrisë dhe shoqërisë civile, veçanërisht në fushat e trajnimit për aftësitë digjitale dhe integritit të teknologjive të reja në arsim dhe shëndetësi.



4. HULUMTIMET RELEVANTE MBI TEMËN E PËRFSHIRJES DIGJITALE

4.1. Vështrim i përgjithshëm mbi rezultatet e hulumtimit

Hulumtimet që trajtojnë përfshirjen digjitale në Kosovë mbeten jashtëzakonisht të kufizuara dhe nuk ekziston asnjë hulumtim i njohur në nivel kombëtar që i dedikohet ekskluzivisht kësaj teme. Shumica e provave të disponueshme për përfshirjen digjitale vijnë nga organizata ndërkombëtare ose rajonale, siç janë Banka Botërore, UNICEF dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), të cilat kanë bërë vlerësime si pjesë e përpjekjeve më të gjera për të monitoruar transformimin dhe përfshirjen digjitale në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Këto studime kanë tendencë të përqendrohen në infrastrukturën digjitale, mungesën e aftësive dhe edukimin digjital, shpesh duke përdorur Kosovën si rast shembull në krahasimet rajonale. Edhe pse disa raporte prekin faktorët që çojnë në përjashtimin digjital dhe përmendin grupet e cënueshme, siç janë popullsitë rurale, të rinjtë në gjendje të pafavorshme socio-ekonomike dhe pakicat etnike, nuk ka hulumtime sistematike kombëtare ose vlerësime të politikave specifike për përfshirjen digjitale. Në pjesën në vazhdim, paraqesim përfundimet nga pesë raporte hulumtuese që ofrojnë provat më të rëndësishme të disponueshme mbi përjashtimin dhe përfshirjen digjitale në Kosovë.

1) Indeksi i Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale në Ballkanin Perëndimor – Raporti DESI 2022 i BB-së (RCC, 2022)

Raporti identifikon disa faktorë kyç që kontribuojnë në përjashtimin digjital në Kosovë. Nivelet e ulëta të aftësive digjitale përbëjnë faktorin kryesor të përjashtimit, me vetëm 28% e personave që kanë të paktën aftësi digjitale bazike, krahasuar me mesataren e BE-së prej 54%. Ka mungesë të ndjeshme të aftësive më të avancuara digjitale, me vetëm 14% të personave që zotërojnë aftësi digjitale mbi ato themelore. Gratë mbeten të nënparaqësura në radhët e specialistëve të TIK-ut (20.2%), megjithëse pak mbi mesataren e BE-së. Raporti nuk i përmend në mënyrë eksplicite grupet e cënueshme përtej pabarazive gjinore, por në mënyrë të nënkuptueshme sugjeron që të rinjtë dhe popullsitë në zonat rurale mund të përballen me përjashtim më të madh, duke marrë parasysh mbulimin më të ulët me infrastrukturë të internetit me brez të gjerë në rajone të caktuara dhe edukimin e kufizuar digjital. Në anën tjetër, raporti i nënvizon faktorët që mbështesin përfshirjen digjitale në Kosovë. Lidhja me internet me brez të gjerë dallohet në mënyrë pozitive, me një qasje pothuajse universale të amvisërive në rrjetin me brez të gjerë prej 99.7%, duke e tejkaluar dukshëm mesataren e BE-së (77.8%). Rreth 45% e amvisërive gëzojnë internet me shpejtësi të lartë (≥ 100 Mbps). Përveç kësaj, Kosova ka çmimet më të ulëta të internetit me brez të gjerë në rajon, duke e bërë qasjen në internet financiarisht të përballueshme.

2) Peizazhi i të nxënimit digjital në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut (UNICEF, 2022)

Përkundër shkallës së lartë të lidhjes së amvisërive në internet, Kosova përballet me një **përrjashtim të theksuar digjital të grupeve të marginalizuara**, veçanërisht të rinjve romë, ashkalinj dhe egjiptianë, me dallime të theksuara ndërmjet gjinive. Për shembull, vetëm 75% e grave të reja rome, ashkali dhe egjiptiane përdorin kompjuterë, krahasuar me 90% të bashkëmoshatarëve të tyre meshkuj. Përveç kësaj, mungesa e infrastrukturës së mjaftueshme të TIK-ut në shkolla dhe kompetencat e kufizuara të mësimdhënësve i kontribuojnë edhe më shumë përrjashtimit, duke pasur ndikim veçanërisht tek fëmijët në gjendje të vështirë të cilëve u mungojnë sistemet adekuate mbështetëse.

Iniciativat kryesore për përrfshirje përrfshijnë krijimin e platformës digjitale kombëtare «Shkollat.org», e cila ofron përmbajtje të përrshtatur me kurrikulën në shumë gjuhë, duke rritur kështu ndjeshëm qasjen në edukim digjital cilësor. Gjatë pandemisë COVID-19, 2,500 mësimdhënës morën pjesë në trajnimet për aftësi digjitale bazike, duke mundur kalimin në mësimdhënie në distancë dhe të kombinuar. Për më tepër, UNICEF-i mbështeti përrmirësimet e lidhjes nëpër shkolla dhe sigurimin e pajisjeve të dedikuara posaçërisht për të rinjtë e marginalizuar, përrfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.

3) Nevojat dhe mungesat në aftësitë digjitale në Ballkanin Perëndimor - fushëveprimi dhe objektivat për një vlerësim të plotë (RCC, 2021)

Faktorët e përrjashtimit digjital: Raporti nënvizon një hendek digjital në Kosovë, duke treguar një mospërrputhje të dukshme të aftësive në tregun e punës, me mungesë të aftësive dhe njohurive digjitale, veçanërisht

te gjeneratat e vjetra dhe popullata rurale. Janë vërejtur pabarazi në aftësitë digjitale ndërmjet zonave urbane dhe rurale, duke çuar kështu në përrjashtimin e komuniteteve rurale nga shërbimet dhe mundësitë digjitale. Gratë, veçanërisht në zonat rurale, identifikohen si grupe të cenueshme që përrballen me rreziqe më të mëdha nga përrjashtimi digjital për shkak të shkallës së ulët të qasjes në trajnime digjitale dhe në mjetet e TIK-ut.

Faktorët e përrfshirjes digjitale: Zhvillimi i aftësive digjitale po integrohet gjithnjë e më shumë në strategjitë kombëtare të arsimit, duke theksuar veçanërisht arsimin dhe aftësimin profesional (AAP) dhe kurrikulat e orientuara drejt TIK-ut që kanë në fokus të rinjtë. Prania e projekteve dhe iniciativave të financuara nga donatorët, që fokusohen në përrmirësimin e shkathtësive digjitale në shkolla, në qendra të arsimit dhe aftësimin profesional dhe në institucione të arsimit të lartë, kontribuon në përrfshirjen digjitale. Ekosistemet e bizneseve të reja dhe qendrat e trajnimit për TIK, siç janë qendrat e inovacionit dhe qendrat e TIK-ut, po shfaqen si stimulues të rëndësishëm të përrfshirjes digjitale duke ofruar trajnime dhe mundësi rrjetëzimi të qasshme për të rinjtë dhe sipërrmarrësit.

4) Përrmbledhje e politikave: Roli i digjitalizimit në transformimin e shoqërive të Ballkanit Perëndimor (Mrdovic, 2023)

Përrmbledhja e politikave nuk e trajton në mënyrë specifike kontekstin e Kosovës në detaje, por nxjerr në pah sfidat e përrgjithshme relevante për Kosovën si pjesë e Ballkanit Perëndimor. Ai thekson faktorët që **çojnë në përrjashtim digjital**, siç janë niveli i ulët i af-

tësive digjitale, dallimet e konsiderueshme urbane-rurale, infrastruktura digjitale e pamjaftueshme dhe besimi i kufizuar i qytetarëve në shërbimet digjitale. Ai po ashtu identifikon faktorët që kontribuojnë në përfshirjen digjitale, duke përfshirë mbështetjen e BE-së dhe atë rajonale, përmirësimet e lidhjes me internet me brez të gjerë, përpjekjet për të përmirësuar aftësitë dhe edukimin digjital, si dhe iniciativat që promovojnë shërbimet e qeverisjes elektronike dhe sigurinë kibernetike. Edhe pse nuk e përmendin në mënyrë eksplicite dhe të detajuar Kosovën, është e qartë se vrojtimet e përgjithshme mbi sfidat dhe mundësitë e transformimit digjital vlejnë edhe për kontekstin e Kosovës.

5) Transformimi i arsimit në Kosovë me pasaportën e të nxëniet - Rasti i Shkollat.org - Përmbledhje e politikave (Cárceles Martínez-Lozano & Dreesen, 2023)

Kjo përmbledhje e politikave paraqet gjetjet e hershme nga një studim gjithëpërfshirës me metoda të kombinuara mbi zbatimin dhe ndikimin e platformës kombëtare të të nxëniet digjital të Kosovës, Shkollat.org. Ky hulumtim e konfirmon rolin e rëndësishëm të platformës në promovimin e përfshirjes digjitale, veçanërisht gjatë dhe pas pandemisë COVID-19, duke siguruar qasje të barabartë në përmbajtje të harmonizuara me kurrikulën, si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë serbe. Studimi mbështetet në të dhëna sasore të marra nga 1,212 mësimdhënës dhe në intervistat cilësore në shtatë komuna, duke zbuluar përdorimin e gjerë të platformës për mësim të kombinuar dhe mësim plotësues, si dhe përmirësime të dukshme në kompetencën digjitale të mësimdhënësve. Në mënyrë thelbësore, përmbledhja identifikon gjashtë faktorë që mundësojnë shkallëzimin e përfshirjes dig-

jitale: përmirësimin e platformës, trajnimin e mësimdhënësve, përmbajtjen e lokalizuar, qasjen në pajisje, lidhjen e shkollave [në internet] dhe koordinimin institucional, duke theksuar se, ndonëse platforma Shkollat.org ofron një themel të fortë, kërkohen përpjekje më të gjera sistemike për të kapërcyer barrierat me të cilat përballen nxënësit në pozitë të pafavorshme dhe shkollat rurale. Hulumtimi nënvizon se platformat digjitale të të nxëniet, siç është Shkollat.org, mund të jenë mjete të fuqishme për barazi nëse shoqërohen me investime të qëndrueshme në infrastrukturë, me mbështetje pedagogjike dhe me bashkëpunim ndërsektorial.

6) Kosovë: Vlerësimi i gatishmërisë digjitale të sistemit arsimor (Banka Botërore, 2024a)

Ky vlerësim identifikon disa faktorë të rëndësishëm që kontribuojnë në përjashtimin digjital brenda sistemit arsimor të Kosovës. Një ndarje e theksuar urbane-rurale e kufizon dukshëm infrastrukturën digjitale në shkollat rurale, të cilave shpesh u mungon lidhja adekuate e internetit dhe pajisjet e nevojshme digjitale, duke ulur kështu cilësinë e të nxëniet dhe mundësitë e nxënësve për të mësuar. Për më tepër, pabarazitë ekonomike e përkeqësojnë këtë situatë, pasi nxënësit nga familje në gjendje të vështirë socioekonomike shpesh kanë qasje të kufizuara në mjetet digjitale në shtëpi, duke rezultuar kështu në kompetenca digjitale relativisht më të ulëta. Përveç kësaj, Kosova përballlet me sfida që kanë të bëjnë me aftësitë e kufizuara digjitale të mësimdhënësve, ku shumë punëtorë të arsimit kanë aftësi dhe përvojë të pamjaftueshme digjitale në zbatimin e metodave pedagogjike digjitale. Kjo mangësi i përjashton edhe më shumë nxënësit nga angazhimi në përvoja gjithëpërf-

shirëse të të nxënësve digjital. Përkundër disa përmirësimeve të përgjithshme infrastruktura e përgjithshme vazhdon të mbetet joadekuate, e karakterizuar me probleme të vazhdueshme lidhur me cilësinë, përballueshmërinë dhe disponueshmërinë e lidhjes së qëndrueshme të internetit dhe pajisjeve digjitale në shkolla, duke penguar kështu edhe menaxhimin efektiv administrativ dhe administrimin e të dhënave për arsimin.

Megjithatë, raporti nënvizon edhe përpjekjet premtuese dhe mundësitë që promovojnë përfshirjen digjitale. Kosova ka miratuar disa nisma politike, përfshirë Projekt Strategjinë për Digjitalizim të Arsimit, Agjendën Digjitale të Kosovës 2030, dhe Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, të cilat të gjitha theksojnë zhvillimin e aftësive dhe përfshirjen digjitale. Nismat që kanë për qëllim zhvillimin e një kornize të lokalizuar të kompetencës digjitale si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit paraqesin një përpjekje të rëndësishme sistematike për të përmirësuar edukimin digjital në mënyrë gjithëpërfshirëse në tërë sektorin e arsimit. Për më tepër, është parë një treg në zhvillim për teknologjinë arsimore (EdTech) në Kosovë, me mbështetjen e qeverisë për zgjidhjet digjitale inovative për të avancuar praktikën arsimore gjithëpërfshirëse.

Propozohen rekomandime specifike për të përmirësuar edhe më tej përfshirjen digjitale. Së pari, prioriteti i investimeve të synuara për të përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën digjitale, veçanërisht në shkollat rurale, është thelbësor për të zvogëluar hendekun ekzistues urban-rural. Së dyti, zbatimi i një kornize gjithëpërfshirëse dhe të lokalizuar të aftësive digjitale për nxënësit, mësuesit

dhënësit dhe administratorët e shkollave do të forconte në mënyrë të përgjithshme edukimin digjital. Së fundmi, rekomandohet të nxitet një ekosistem i fuqishëm i Ed-Tech përmes rritjes së bashkëpunimit ndërmjet organeve qeveritare, sektorit privat dhe akademisë, për të zhvilluar teknologji arsimore të qëndrueshme, të përballueshme dhe relevante për kontekstin.

7) Vlerësimi i kompetencës digjitale të mësuesdhënësve të klasave 1-12 në Kosovë: Një studim përmes këndvështrimit të DigCompEdu dhe TPACK (Pireva-Nuçi, 2025)

Ky studim vlerëson kompetencën digjitale të 441 mësuesdhënësve të klasave 1–12 në Kosovë duke përdorur kornizën DigCompEdu të BE-së përmes instrumentit SELFIE për Mësuesdhënësit. Edhe pse hulumtimi është specifik për Kosovën, gjetjet e tij janë të rëndësishme në përgjithësi për përpjekjet kombëtare për përfshirje digjitale në arsim. Ai zbulon se mësuesdhënësit në përgjithësi ndihen të sigurt në përdorimin e mjeteve digjitale, veçanërisht për menaxhimin e burimeve dhe angazhimin e nxënësve, por shfaqin një kompetencë më të dobët në integrimin e këtyre mjeteve në praktikën e mësimit dhe vlerësimin. Rezultatet më të mira u regjistruan në fushat që kanë të bëjnë me qasjen dhe përdorimin e burimeve digjitale, ndërsa më të dobëtat ishin në integrimin pedagogjik të teknologjisë. Moshë dhe përvoja po ashtu luajtën rol – mësuesdhënësit e moshës 30–49 vjeç dhe ata me 10–19 vjet përvojë demonstrojnë kompetencë më të fortë digjitale. Studimi nënvizon nevojën për të kaluar nga trajnimi thjesht teknik për aftësitë digjitale drejt

trajnimin për zbatim pedagogjik të mjeteve digjitale në mësimdhënie. Ai po ashtu sugjeron adoptimin e një qasjeje të përzier që kombinon kornizën DigCompEdu me TPACK (Njohuritë Teknologjike Pedagogjike të Përmbajtjes) për të forcuar zhvillimin e mësimdhënësve. Edhe pse si i tillë nuk është i fokusuar në përfshirjen digjitale, studimi thekson rëndësinë e zhvillimit profesional në ndërtimin e kapaciteteve digjitale kuptimplota në shkolla, gjë që është thelbësore për zvogëlimin e hendeqeve digjitale në arsim.

8) Një perspektivë ndërkombëtare mbi njohuritë digjitale - Rezultatet nga ICILS 2023 (Fraillon, 2024)

Studimi Ndërkombëtar për Aftësitë Kompjuterike dhe Informatike (ICILS) vlerëson se sa mirë janë të përgatitur nxënësit për të përdorur teknologjinë digjitale për nxënie, komunikim dhe menaxhim të informacionit. Në ICILS 2023, Kosova pati rezultat dukshëm nën mesataren ndërkombëtare në njohuritë kompjuterike dhe informatike (CIL), me një rezultat mesatar të nxënësve prej 356 pikësh, duke e renditur atë të parafundit në mesin e 34 sistemeve arsimore pjesëmarrëse, vetëm para Azerbajxhanit. Vetëm 30% e nxënësve në Kosovë arritën Nivelin 2 ose më lartë në shkallën e aftësive CIL, krahasuar me mesataren ndërkombëtare prej 49%, ndërsa rreth 70% mbetën në Nivelin 1 ose më poshtë, duke treguar kompetenca të kufizuara digjitale. Rezultatet e Kosovës tregojnë edhe për një hendek të konsiderueshëm digjital bazuar në qasjen në teknologji. Nxënësit që raportuan se kishin gjithmonë qasje në kompjuter për detyrat e shkollës morën mesatarisht 67 pikë më shumë se bashkëmoshatarët e tyre pa qasje

të vazhdueshme, një pabarazi shumë më e madhe se mesatarja ndërkombëtare. Për më tepër, vetëm 16% e nxënësve në Kosovë ndjekin shkolla që raportojnë se përdorin sistem të menaxhimit të të nxënësve - ndër më të ulët në këtë studim - duke theksuar integrimin e kufizuar të mjeteve digjitale në shkollimin e përditshëm.

9) Programet e Reformës Ekonomike të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Gjeorgjisë, Kosovës*, Moldavisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Turqisë: Përmbledhja e Komisionit dhe vlerësimet e vendeve (Komisioni Evropian, 2004b)

Ky vlerësim tregon se Kosova po përparon gradualisht drejt transformimit digjital, megjithëse vazhdon të ketë pabarazi të konsiderueshme. Nga njëra anë, Kosova demonstroi themele të forta për përfshirje digjitale, me mbulim universal të infrastrukturës fikse të internetit me brez të gjerë që mbulon 100% të familjeve në të gjithë vendin. Përveç kësaj, Kosova ka zhvilluar një sektor modest por me rritje të shpejtë të TIK-ut, duke shkëlqyer veçanërisht në zhvillimin e softuerëve, krijimin e aplikacioneve për telefonat e mençur dhe dizajnimin e faqeve të internetit, që veçanërisht i dedikohen tregjeve të jashtme. Megjithatë, raporti nënvizon pengesat e vazhdueshme **për përfshirje digjitale**, duke vënë në dukje veçanërisht përparimin e kufizuar në digjitalizimin e shërbimeve publike, i cili ende është në fazën fillestare. Për më tepër, përkundër një progresi në zbatimin e iniciativave të tregtisë elektronike, përvetësimi aktual i tregtisë elektronike nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është i kufizuar, duke pasqyruar një boshllëk themelor në adoptimin digjital

nga ndërmarrjet më të vogla. Agjenda Digjitale 2030 e miratuar kohëve të fundit konsiderohet një zhvillim pozitiv, duke ofruar një kornizë strategjike gjithëpërfshirëse që synon përsheptimin e transformimit digjital.

10) Raporti i Progresit të BE-së për Kosovën 2024 (Komisioni Evropian, 2024a)

Raporti i Progresit i BE-së për vitin 2024 nxjerr në pah zhvillimet e rëndësishme dhe sfidat e vazhdueshme për Kosovën në fushën e transformimit digjital, duke theksuar aspekte të besimit digjital dhe sigurisë kibernetike. Kosova ka forcuar kornizën e saj të sigurisë kibernetike duke miratuar një strategji të re të sigurisë kibernetike (2023-2027) dhe duke e përafuar pjesërisht legjislacionin e saj me Direktivën e BE-së për NIS, megjithëse mbetet të bëhet përafrimi i mëtejshëm me Direktivën NIS2. Raporti nënvizon urgjencën e hartimit të politikave të fuqishme për të garantuar sigurinë në internet, veçanërisht mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi në internet. Ndonëse Kosova ka bërë hapa përpara drejt përafrimit me Rregulloren eIDAS dhe avancimit të identifikimit elektronik kombëtar (eID), përafrimi i mëtejshëm me Kornizën e re të Identitetit Digjital të BE-së dhe zbatimi i një portofoli kombëtar të identitetit digjital janë thelbësore për të rritur besimin dhe angazhimin e sigurt digjital.

4.2. Përmbledhje e gjetjeve të hulumtimeve

Rishikimi i hulumtimeve të disponueshme dhe të dhënave nga terreni sugjeron disa gjetje të qën-

drueshme sa i përket gjendjes së përfshirjes digjitale në Kosovë. **Së pari**, ndërsa mbulimi kombëtar me internet me brez të gjerë është pothuajse universal, **qasja në teknologjitë digjitale mbetet e pabarabartë**, veçanërisht për komunitetet rurale dhe grupet e marginalizuara socioekonomike. Kjo përforcohet si nga vlerësimi i sistemit arsimor nga Banka Botërore për vitin 2024, ashtu edhe nga ICILS 2023, të cilat nxjerrin në pah mangësitë strukturore në shkollat rurale, përfshirë lidhjen e dobët me internet dhe mungesën e pajisjeve digjitale. Intervistat në terren i konfirmojnë këto konstatime, duke treguar pengesat e vazhdueshme në qasje të familjeve rurale dhe atyre me të ardhura të ulëta.

Së dyti, aftësitë e kufizuara digjitale në të gjitha segmentet e popullsisë– veçanërisht tek të rriturit më të moshuar, personat me nivel më të ulët arsimor dhe madje edhe mësimdhënësit – përbëjnë një pengesë të vazhdueshme për pjesëmarrjen efektive digjitale. Sipas RCC (2022), vetëm 28% e popullsisë zotëron aftësi digjitale bazike, dhe ICILS 2023 tregon se vetëm 30% e nxënësve të klasës së 8-të përmbushin standardin minimal ndërkombëtar për njohuritë kompjuterike dhe informatike. Studimi i Pireva-Nuçi (2025) shton se edhe në radhët e mësimdhënësve, përdorimi pedagogjik i mjeteve digjitale mbetet i pazhvilluar, duke treguar kështu mangësi sistematike në kompetencën digjitale në nivele të shumfishta të sistemit arsimor. Përveç këtyre, raporti i UNICEF-it (2022) thekson pabarazitë e konsiderueshme gjinore, veçanërisht tek të rinjtë romë, ashkalinj dhe egjiptianë, ku pjesëmarrja digjitale në radhët e grave të reja është dukshëm më e ulët

krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre meshkuj, duke thelluar edhe më shumë hendekun digjital.

Së treti, sistemi arsimor ka bërë disa hapa drejt digjitalizimit - veçanërisht përmes platformave si Shkollat.org dhe iniciativave të trajnimit të filluara gjatë pandemisë COVID-19 - por **ende nuk është e përgatitur plotësisht për të mbështetur barazinë në të nxënit digjital**. Investimet në infrastrukturë dhe në ndërtimin e kapaciteteve mbeten të pamjaftueshme dhe të fragmentuara. Të dhënat nga terreni vazhdimisht tregojnë për qasje të dobët në internet në shkolla, mungesë të mbështetjes teknike dhe përmbajtje digjitale jo të përshtatur sa duhet, duke prekur veçanërisht grupet e nxënësve të cenueshëm.

Së fundmi, ndonëse ekzistojnë programe të edukimit digjital, ato janë të kufizuara në fushëveprim dhe qëndrueshmëri. Shumica e iniciativave drejtohen nga donatorët, duke pasur në fokus të rinjtë dhe mësim-

dhënësit në periudhën gjatë ose menjëherë pas pandemisë. Megjithatë, intervistat në terren dhe informacionet e shoqërisë civile nënvizojnë mungesën e mundësive të strukturuar të trajnimit të udhëhequra nga shteti për grupet e tjera të cenueshme, siç janë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet rurale dhe gratë - veçanërisht ato nga komunitetet e marginalizuara, siç janë popullatat rome, ashkali dhe egjiptiane, të cilat përballen me pengesa të ndërlikuara për shkak të qasjes më të ulët dhe mundësive më të pakta për zhvillimin e aftësive digjitale. Kjo lë pjesë të konsiderueshme të popullsisë pa mbështetje të mjaftueshme për të marrë pjesë në jetën digjitale.

(Për përputhje të detajuar me dëshmitë nga hulumtimi, shihni Shtojcën 2.)



5. SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE KOMBËTARE

5.1. Identifikimi dhe përshkrimi i tri nismave/projekteve më efektive të udhëhequra nga qeveria ose sektori civil

Në vitet e fundit, disa nisma qeveritare dhe të shoqërisë civile në Kosovë kanë kontribuar në mënyrë efektive në përfshirjen digjitale. Në mesin e tyre, shquhen tri projekte për shkak të shkallës së tyre të rëndësisë, objektivave të qarta dhe ndikimit pozitiv në grupe të ndryshme të popullsisë. Këto nisma janë përqendruar kryesisht në përmirësimin e lidhjes me internet me brez të gjerë në zonat më pak të mbuluara, digjitalizimin e shërbimeve publike dhe forcimin e edukimit digjital.

1) Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE), i zbatuar nga viti 2014-2024 nga Ministria e Ekonomisë me mbështetjen e Bankës Botërore, që synonte të rriste përfshirjen digjitale duke zgjeruar internetin me shpejtësi të lartë në zonat rurale më pak të mbuluara, duke forcuar konektivitetin digjital në shkollat fillore dhe të mesme dhe duke ofruar trajnime për aftësi digjitale për të rinjtë. Projekti shtriu me sukses infrastrukturën e internetit me brez të gjerë në 203 fshatra, duke përmirësuar ndjeshëm penetrimin dhe lidhjen e internetit. Ai siguroi instalime të avancuara të rrjetit të brendshëm në 197 shkolla dhe themeloi Rrjetin e

Kosovës për Hulumtim dhe Edukim (KREN), duke garantuar konektivitet të qëndrueshëm për institucionet akademike. Përveç kësaj, projekti trajnoi 2,190 të rinj, përfshirë 881 gra, duke arritur kështu rezultate premtuese në punësim (World Bank, 2024b). Palët e interesuara theksuan se, ndonëse përmirësimet në infrastrukturë janë të rëndësishme, vazhdojnë të shfaqen sfida në drejtim të shfrytëzimit efektiv të burimeve digjitale. Ata vunë në dukje mungesat të konsiderueshme të aftësive digjitale tek popullata e gjerë, që prek veçanërisht të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet me kualifikim më të ulët arsimor.

2) Platforma eKosova, e lansuar në vitin 2020 dhe e menaxhuar nga Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (ASHI), shërben si një qendër e centralizuar digjitale që ofron qasje online në 230 shërbime shtetërore, përfshirë certifikatat e gjendjes civile, dokumentet pronësore, pagesat e tatimeve dhe aplikimet për përfitime sociale. Deri në vitin 2024, eKosova tejkaloi numrin prej një milion përdoruesish të regjistruar, duke shënuar kështu një moment historik në transformimin digjital të Kosovës. Së fundmi, platforma është zgjeruar përmes komponentit e-Komuna, duke u mundësuar qytetarëve të angazhohen drejtpërdrejt me shërbimet komunale. Megjithatë, palët e interesuara nënvizuan disa sfida të vazhdueshme, veçanërisht ndërëgjegjësimin e ulët publik për shërbimet në dispozicion dhe kufizimet financiare që pengojnë aktivitetet promovuese. Ata gjithashtu vunë re vonesa të konsiderueshme dhe

adoptim të kufizuar të teknologjisë nga disa ministri, veçanërisht ato të mirëqenies sociale dhe të arsimit, që pengojnë ofrimin gjithëpërfshirës të shërbimeve digjitale. Planet e ardhshme përfshijnë përmirësime të avancuara të qasjes, siç janë njohja e zërit, dhe krijimi i qendrave fizike të ndihmës “One-Stop-Shop” për t’i shërbyer më mirë grupeve të përjashtuara në aspektin digjital.

3) **Shkollat.org**, platformë kombëtare e Kosovës për të nxënit digjital, iniciuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në partneritet me UNICEF-in, u lansua në vitin 2021 për të lehtësuar arsimin digjital gjithëpërfshirës, të barabartë dhe me nxënësin në qendër. Platforma ofron përmbajtje të gjerë multimediale të përshtatur me kurrikulën dhe integron mjete digjitale thelbësore si Microsoft Teams dhe Office 365. Platforma Shkollat.org ka rritur ndjeshëm angazhimin e mësimitdhënësve në nivel vendi dhe qasjen e nxënësve në burime cilësore arsimore, nga i cili kanë përfituar veçanërisht komunitetet e pambështetura. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimitdhënësve dhe mbështetja e dedikuar për grupet e cenueshme të nxënësve u rekomanduan si prioritete thelbësore për përmirësimin e arsimit digjital (Cárceles Martínez-Lozano & Dreesen, 2023). Pavarësisht këtyre sukseseve, palët e interesuara theksuan disa pengesa të konsiderueshme, përfshirë infrastrukturën teknologjike të vjetruar ose të pamjaftueshme në shkolla, qasjen e kufizuar në internet jashtë zyrave administrative dhe kompetencat e pamjaftueshme digjitale të mësimitdhënësve. Ata po ashtu nënvizuan

vonesat administrative në nivel të Ministrisë dhe mungesën e një kornize të fuqishme rregullatore për të udhëhequr zhvillimin dhe përdorimin e përmbajtjes digjitale.

Për informacione më të detajuara mbi këto projekte, ju lutem shihni Shtojcën 3.

5.2. Identifikimi dhe përshkrimi i shkurtër i nismave/projekteve të tjera që kishin potencial, por u përballën me sfida

Ndonëse disa nisma kanë demonstruar sukses të konsiderueshëm, të tjerat kanë hasur në vështirësi të mëdha të cilat kufizuan ndikimin e tyre potencial. Është shumë me rëndësi të analizohen ato projekte, pasi ofrojnë njohuri të vlefshme mbi mangësitë në zbatim, problemet e koordinimit dhe barrierat që pengojnë transformimin digjital. Një prej shembujve më të mirë është ai i prokurimit të pajisjeve digjitale për institucionet e arsimit parauniversitar, i realizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Ky projekt trevjeçar u realizua për të mbështetur zbatimin e Strategjisë së Arsimit të Kosovës 2022–2026, veçanërisht masat që lidhen me pajisjen e institucioneve parauniversitare me pajisje digjitale. Iniciativa ishte në përputhje të ngushtë me projektin KODE të Ministrisë së Ekonomisë, i cili siguroi lidhje të internetit dhe infrastrukturën e brendshme LAN në shkolla, ndërsa projekti i MASHTI-t synonte të sigurote furnizimin me pajisjet e nevojshme digjitale. Megjithëse komunitat i

përfunduan formularët e vlerësimit të nevojave nga fundi i vitit 2022 deri në mars 2023 dhe u sigurua një buxhet i dedikuar në shumën prej 18 milionë eurosh për periudhën 2023–2025, asnjë procedurë prokurimi nuk është iniciuar gjatë viteve 2023 dhe 2024, dhe në Ligjin për Buxhetin e vitit 2025, kjo shumë u reduktua më pas në 15 milionë euro për periudhën 2025–2027.

Kjo mungesë e vazhdimësisë, pavarësisht përgatitjes së plotë dhe financimit të konfirmuar, përbën një dështim serioz në zbatim, duke kufizuar ndjeshëm mundësinë e projektit për të arritur objektivat e synuara dhe për të përmirësuar përfshirjen digjitale brenda sektorit të arsimimit në Kosovë.



6. SFIDA KRYESORE DHE FUSHAT PËR PËRMIRËSIM

6.1. Sfidat në sigurimin e përfshirjes digjitale

Pavarësisht progresit të përshkruar në strategjitë kombëtare dhe ndërhyrjet e mbështetura nga donatorët, Kosova përballet me disa sfida sistemike në sigurimin e përfshirjes digjitale për të gjithë qytetarët:

1. Pabarazia digjitale mes zonave urbane dhe rurale

Vazhdon të ekzistojë një pabarazi e dukshme midis zonave urbane dhe rurale për sa i përket cilësisë së lidhjes në internet, disponueshmërisë së infrastrukturës dhe qasjes në mjetet digjitale. Shkollat në zonat rurale, veçanërisht ato më të vogla dhe më të largëta, vuajnë nga infrastruktura digjitale e dobët, duke rezultuar në përvoja arsimore digjitale me cilësi më të ulët dhe mundësi të kufizuara për nxënësit dhe mësuesit në këto zona.

2. Nivelet e ulëta të aftësive digjitale të të gjitha grupet e popullsisë

Kosova përballet me një mungesë të theksuar të aftësive digjitale të mesin e grupeve të ndryshme të popullsisë, veçanërisht tek të moshuarit, personat me nivele më të ulëta arsimimi dhe komunitetet e marginalizuara etnike siç janë romët, ashkalitë dhe egjiptianët. Për shembull, vetëm 28% e popullsisë zotëron aftësi digjitale bazike, krahasuar me mesataren e BE-së prej 54%, duke theksuar një nevojë urgjente për ndë-

rhyrje të gjerë në edukimin digjital. Edhe ata me qasje adekuate në internet shpesh nuk kanë kompetenca thelbësore për një angazhim të mirëfilltë në shërbimet digjitale.

3. Fokus i kufizuar në grupet e cenueshme

Ndonëse Kosova ka dokumente të përgjithshme strategjike që promovojnë transformimin digjital dhe përfshirjen digjitale, ekziston një mungesë e dukshme e politikave dhe masave të synuara që mbështesin në mënyrë të qartë popullatat e cenueshme. Strategjitë aktuale kombëtare nuk arrijnë t'i adresojnë në mënyrë adekuate sfidat unike të përjashtimit digjital me të cilat përballen banorët e zonave rurale, komunitetet në pozitë të vështirë socioekonomike, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat etnike.

4. Koordinimi dhe zbatimi i pamjaftueshëm i politikave digjitale

Edhe pse Kosova ka zhvilluar strategji ambicioze siç janë Agjenda Digjitale e Kosovës 2030 dhe Strategjia e Qeverisjes Elektronike, zbatimi efektiv i këtyre politikave pengohet nga koordinimi i dobët ndërinstucional, burimet e kufizuara dhe mbështetja e tepruar në financimin e donatorëve. Si pasojë, progresi drejt arritjes së objektivave të përfshirjes digjitale mbetet i ngadaltë dhe i fragmentuar. Përgjegjësitë institucionale mbeten të paqarta, duke shkaktuar boshllëqe dhe joefikasitet.

5. Ekosistemi i pazhvilluar i arsimit digjital

Pavarësisht investimeve dhe nismave të fundit për të nxitur arsimin digjital (p.sh., platformat si Shkollat.org), sistemi arsimor në Kosovë nuk është i përshtatur ende në mënyrë të mjaftueshme për të integruar plotësisht veglat digjitale në procesin e mësimdhënies dhe të nxënimit. Pengesat kryesore përfshijnë infrastrukturën e pamjaftueshme

të TIK-ut në shkolla, kompetencat e kufizuara digjitale të punëtorëve të arsimit dhe mungesën e investimeve të qëndrueshme në zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe sistemet mbështetëse për edukimin digjital. Vështirësitë administrative dhe zbatimi jo konsistent dobësojnë më tej efektivitetin e nismave aktuale.

6.2. Fushat për përmirësim

Bazuar në sfidat e identifikuar, fushat e mëposhtme kyçe për përmirësim janë parakusht thelbësor për përparim të mëtejshëm në përfshirjen digjitale në Kosovë:

1. Zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës digjitale në zonat rurale dhe të pambuluara sa duhet

Nevojiten investime shtesë për të përmirësuar infrastrukturën digjitale në komunat, shkollat dhe institucionet publike rurale, duke siguruar lidhje të qëndrueshme të internetit dhe qasje në pajisjet digjitale. Kjo përfshin mbështetjen e vazhdueshme për nismat si Projekti KODE, së bashku me zbatimin transparent dhe me kohë të prokurimit të planifikuar të pajisjeve digjitale në arsim. Duhet të bëhet prioritet përshpejtimi i projekteve të infrastrukturës dhe sigurimi i shpërndarjes efektive të resurseve. (Adreson sfidat 1 dhe 5)

2. Promovimi i shërbimeve publike digjitale gjithëpërfshirëse dhe të qasshme

Shërbimet digjitale duhet të planifikohen duke pasur parasysh parimin e gjithëpërfshirjes, duke garantuar qasje për personat me aftësi të kufizuara, disponueshmëri në të gjitha gjuhët zyrtare, si dhe procedura të thjeshtësuara për përdoruesit me nivel të ulët të shkathtësive digjitale. Fushatat e ndërgjegjësimit dhe shërbimet mbështetëse

(p.sh., sportelet e ndihmës, naviguesit digjitalë, dhe pikat fizike të ndihmës) mund të lehtësojnë edhe më shumë përdorimin nga grupet e cenueshme. Shtrirja proaktive dhe dizajni miqësor për përdoruesit janë thelbësore për përmirësimin e angazhimit në mesin e popullatave të pambuluara sa duhet. (Adreson sfidat 1 dhe 3)

3. Rritja graduale e zhvillimit të aftësive digjitale përmes mësimit gjatë gjithë jetës

Nevojitet një qasje kombëtare ndaj zhvillimit të aftësive digjitale, që shtrihet përtej arsimit formal për të përfshirë trajnimin e bazuar në komunitet, mësimin për të rritur dhe iniciativat e përmirësimit të aftësive digjitale për të rriturit më të moshuar, personat me shkallë të ulët të arsimit dhe gratë. Integrimi i kornizave të kompetencës digjitale në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit, i kombinuar me përpjekjet për ndërgjegjësim, është i domosdoshëm për të mbyllur hendekun e aftësive. Programet e strukturuar dhe të qëndrueshme të financuara nga shteti janë të domosdoshme për të përplotësuar iniciativat e mbështetura nga donatorët. (Adreson sfidat 2 dhe 5)

4. Përmirësimi i pedagogjisë digjitale dhe transformimit digjital në nivel të shkollës

Nevojiten investime të mëtejshme në arsimin digjital, veçanërisht në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, integrimin e mjeteve digjitale në praktikën në klasë dhe ofrimin e teknologjive ndihmëse për nxënësit me nevoja të veçanta. Iniciativat në nivel të shkollës duhet të mbështeten me financim të qëndrueshëm, asistencë teknike dhe përputhshmëri me kornizat kombëtare të arsimit digjital. Programet e fokusuara të trajnimit të mësimitdhënësve dhe mbështetja e vazhdueshme pedagogjike janë thelbësore për integrimin efektiv digjital në arsim. (Adreson sfidat 2 dhe 5)

5. Prioritizimi i përfshirjes digjitale në kuadër të zbatimit të strategjive ekzistuese

Përfshirja digjitale duhet të prioritetizohet në mënyrë të qartë brenda planeve të veprimit dhe kornizave të monitorimit të Agjendës Digjitale të Kosovës 2030 dhe Strategjisë së Qeverisjes Elektronike 2023–2027. Kjo do të përfshinte përcaktimin e objektivave, treguesve dhe masave specifike që synojnë zvogëlimin e pabarazive digjitale për grupet e marginalizuara, siç janë popullatat në zonat rurale, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet në gjendje të pafavorshme ekonomike dhe pakicat etnike. Adresimi i qartë i grupeve të cënueshme brenda kornizave strategjike mund të sigurojë veprime të synuara dhe llogaridhënie më të qartë. (Adreson sfidat 2 dhe 3)

6. Forcimi i mekanizmave të koordinimit dhe qeverisjes ndërsektoriale

Përmirësimi i përfshirjes digjitale kërkon bashkëpunim të shtuar në mes të ministrive dhe agjencive përgjegjëse për infrastrukturën digjitale, arsimin, punësimin dhe përfshirjen sociale. Kri-

jimi i një organi të centralizuar koordinues ose forcimi i mekanizmave ekzistues është thelbësor për të siguruar zbatimin efektiv të politikave, për të parandaluar dyfishimin e përpjekjeve dhe për të lehtësuar sinergjitë ndërsektoriale. Strukturat e qeverisjes dhe mekanizmat e llogaridhënies të përcaktuara qartë janë thelbësore për të siguruar zbatimin koherent të politikave. (Adreson sfidën 4)

7. Institucionalizimi i mekanizmave të monitorimit, vlerësimit dhe transparencës

Për të siguruar zbatimin efektiv të nismave të përfshirjes digjitale, Kosovës i duhen sisteme të fuqishme për monitorimin e performancës, raportimin publik dhe vlerësimin e ndikimit. Kjo përfshin mbledhjen e të dhënave të ndara mbi qasjen dhe përdorimin nga të gjitha grupet demografike dhe rishikime të rregullta të objektivave të përfshirjes digjitale. Sistemet transparente të monitorimit dhe raportimi i qasshëm publik janë thelbësore për matjen e ndikimeve, sigurimin e llogaridhënies dhe mbështetjen e përmirësimit të politikave bazuar në dëshmi. (Adreson sfidën 4)



7. REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIM TË POLITIKAVE

Duke u mbështetur në analizën e sfidave sistemike dhe fushat e identifikuara për përmirësim, propozohen rekomandimet e mëposhtme të politikave të synuara. Këto rekomandime janë të bazuara drejtpërdrejt si në hulumtimet të gjera të dokumentacionit, ashtu edhe në informacionet e pasura të siguruar gjatë mbledhjes së të dhënave në terren, përfshirë intervistat dhe grupet e fokusit me palët e interesuara përkatëse. Rekomandimet ndahen në dy kategori: rekomandime të përgjithshme që adresojnë nevojat e përfshirjes digjitale të popullsisë në përgjithësi dhe rekomandime specifike të hartuara për të mbështetur grupet e cenushme që janë në rrezik të përjashtimit digjital.

7.1. Rekomandimet që kanë të bëjnë me popullsinë e përgjithshme

1. Integrimi i aftësive digjitale në arsimin formal dhe joformal

Të integrohet në mënyrë sistematike edukimi digjital në të gjithë kurrikulën kombëtare në të gjitha nivelet e arsimit dhe të sigurohet që programet e mësimit gjatë gjithë jetës - të ofruara nga institucionet publike dhe OSHC-të - të jenë në përputhje me kornizën kombëtar të kompetencave digjitale. Të përditësohen si programet fillestare të trajnimit të mësimdhënësve ashtu edhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional për të pajisur mësimdhënësit dhe edukatorët e të rriturve me

aftësitë e nevojshme pedagogjike për të integruar në mënyrë efektive edukimin digjital në praktikat e tyre të mësimdhënies, duke shkuar përtej trajnimit të thjeshtë teknik. Në mënyrë specifike, t'i jepet përparësi përdorimit pedagogjik të mjeteve digjitale në vend të trajnimit të thjeshtë teknik.

2. Sigurimi i qasjes së plotë dhe lehtësisë së përdorimit të shërbimeve të e-Qeverisjes

Institucionet qeveritare duhet të zbatojnë standarde të njëjta të planifikimit për të siguruar që shërbimet publike digjitale të jenë të disponueshme në të gjitha gjuhët zyrtare dhe të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Thjeshtësimi i procedurave të qasjes dhe zhvillimi i platformave lehtë të përdorshme për pajisjet mobile do të rriste përdorimin nga publiku i gjerë. Përmirësimi i platformave miqësore për pajisje mobile dhe përfshirja e proceseve të thjeshtësuara të autentifikimit (siç janë portofolet e identitetit digjital ose njohja e zërit) duhet të kenë përparësi për të përmirësuar përdorimin.

3. Zgjerimi i pikave të qasjes publike për shërbimet dhe të nxënit digjital

Ngritja ose rigjallërimi i pikave të qasjes publike (p.sh., qendra digjitale komunale, laboratorë e TIK të shkollave me qasje nga komuniteti pas orarit të punës) për t'u mundësuar qytetarëve, veçanërisht atyre pa pajisje personale ose internet, të përfitojnë nga shërbimet online, programet e aftësive digjitale dhe platformat e mësimit elektronik. Këto qendra duhet të ofrojnë edhe mbështetje fizike përmes stafit të dedikuar të asistencës digjitale, duke u fokusuar veçanërisht në përdoruesit e moshuar ose ata që nuk janë të familjarizuar me teknologjitë digjitale.

4. Investimi në politika të bazuara në dëshmi përmes vlerësimeve të rregullta të përfshirjes digjitale

Autorizimi i vlerësimeve periodike në nivel kombëtar për qasjen digjitale, aftësitë dhe shprehinë e përdorimit, të ndara sipas gjinisë, moshës, gjeografisë dhe statusit socio-ekonomik. Gjetjet duhet të shërbejnë si udhëzime në përcaktimin e prioriteteve për ndërhyrje në të gjithë sektorët. Shpërndarja e rregullt publike e këtyre vlerësimeve do të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe angazhimin e palëve të interesuara.

5. **Promovimi i partneriteteve ndërsektoriale për transformimin digjital**

Inkurajimi i nismave të përbashkëta ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat dhe shoqërisë civile për të zhvilluar zgjidhje digjitale gjithëpërfshirëse, për të ndarë bashkërisht infrastrukturën digjitale (p.sh., kapacitetin e internetit me brez të gjerë të pashfrytëzuar në shkolla) dhe për të pilotuar inovacione që janë në të mirë të popullsisë së përgjithshme. Zhvillimi i stimujve dhe kornizave të qarta rregullatore për të nxitur partneritete të qëndrueshme publike-private-shoqëri civile, duke u përqendruar në projekte të shkallëzuara dhe me ndikim në përfshirjen digjitale.

7.2. **Rekomandimet në lidhje me grupet e cenueshme që janë në rrezik të përjashtimit digjital**

1. **Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të synuara për përfshirjen e grupeve të cenueshme**

Hartimi dhe zbatimi i programeve të përfshirjes digjitale me bazë në komunitet që fokusohen në të moshuarit, komunitetet etnike të margjinalizuara, personat me aftësi të kufizuara, familjet me të ardhura të ulëta, e veçanërisht gratë nga këto grupe, të cilat shpesh përballen me pengesa të

ndërlikuara. Këto programe duhet të hartohen së bashku me OSHC-të lokale dhe të ofrohen në ambiente të njohura të komunitetit, siç janë qendrat e komunitetit ose OJQ-të lokale, duke përfshirë përmbajtjen kulturore relevante dhe metoda të qasshme, përfshirë mentorimin ballë për ballë dhe punëtoritë në komunitet që adresojnë në mënyrë specifike barrierat e ndërlikuara me të cilat përballen gratë dhe vajzat në komunitetet e margjinalizuara.

2. **Subvencionimi i lidhjes në internet dhe pajisjeve për familjet e margjinalizuara**

Aplikimi i skemave të subvencioneve ose modeleve të bashkëfinancimit për qasjen në internet dhe pajisjet digjitale për familjet në gjendje të vështirë, mundësisht përmes kriterëve të mirëqenies sociale. Partneritetet publiko-private mund të shfrytëzohen për të ulur kostot dhe për të përmirësuar mbulimin. Në mënyrë specifike, duhet siguruar që kriteret e kualifikimit dhe procedurat e aplikimit për subvencione të jenë të efektshme, transparente dhe të qasshme për të shmangur përjashtimin përmes kompleksitetit administrativ.

3. **Përfshirja e kërkesave për qasje dhe përfshirje në prokurimin publik**

Kriteret e qasjes dhe përdorimit të bëhen të detyrueshme në të gjitha prokurimet publike të TIK-ut, teknologjive arsimore dhe platformave të shërbimeve elektronike - duke siguruar që teknologjitë ndihmëse dhe zgjidhjet e adaptueshme të jenë të disponueshme që në fillim, e jo si zgjidhje e vonshme ose shtesë. Për më tepër, kërkohen auditime të rregullta për të verifikuar përputhshmërinë dhe funksionalitetin praktik të këtyre veçorive të qasjes.

4. **Forcimi i kapacitetit të OSHC-ve për të ofruar programe digjitale gjithëpërfshirëse**

Të ofrohet mbështetje institucionale për OSHC-të që punojnë me grupet e cenueshme për t'i mundësuar atyre të shkallëzojnë programet e aftësive digjitale, të lehtësojnë qasjen në shërbime dhe të veprojnë si ndërmjetësues midis komuniteteve të përjashtuara dhe shërbimeve digjitale publike. Në mënyrë specifike, të krijohen skema të dedikuara grantesh ose mekanizma të qëndrueshëm të financimit që mbështesin nismat e përfshirjes digjitale të udhëhequra nga OSHC-të, të cilat janë treguar të efektshme.

5. **Përfshirja e arsimit digjital gjithëpërfshirës në proceset e të nxënimit profesional dhe alternativ**

Të sigurohet që rrugët jo-tradicionale të arsimit (p.sh., AAP, mësimi i të rriturve, mundësia e dytë e arsimimit) të përfshijnë komponentë të fortë digjitale të përshtatur për nevojat e nxënësve. Të mbështeten njësitë e trajnimit mobil dhe formatet e përziera për të arritur tek popullatat e largëta dhe të pambështetura sa duhet. Të mbështeten njësitë mobile e trajnimit, formatet e të nxënimit të kombinuar dhe mënyrat e personalizuara të të nxënimit të projektuara posaçërisht për komunitetet e largëta dhe grupet e margjinalizuara, duke rritur rëndësinë dhe qasjen e tyre praktike, duke siguruar qasje të ndjeshme ndaj gjinisë dhe shtrirje tek vajzat dhe gratë në grupet rurale dhe të margjinalizuara.



REFERENCAT

- ARKEP. (2019). Rregullore Nr. 36 për Kualitetin e Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike. Gjetur në <https://arkep-rks.org/desk/inc/media/02A53338-D6CD-4503-BFEF-844A899DFA5F.pdf>
- ARKEP. (2025). Përmbledhje e indikatorëve kryesorë të komunikimeve elektronike TM4-2024. Gjetur në <https://arkep-rks.org/desk/inc/media/14d9f124-9634-4261-a14e-82cc982e142f.pdf>
- Banka Botërore. (2018). *KODE-Combined Project Information Documents/Integrated Safeguards Datasheet (PID/ISDS)*. Gjetur në <https://documents1.worldbank.org/curated/en/741671525415353771/pdf/Project-Information-Document-Integrated-Safeguards-Data-Sheet-Kosovo-Digital-Economy-KODE-P164188.pdf>
- Banka Botërore. (2024a). *Kosovo: Education Digital Readiness Assessment 2024*. Gjetur në <https://hdl.handle.net/10986/42761>
- Banka Botërore. (2025). *Poverty & Equity Brief Kosovo 2025*. Gjetur në <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099538504222572520/pdf/IDU-7d7b6dfd-6f2d-4db0-a21f-40a5065eabc3.pdf>
- Cárceles Martínez-Lozano, J., & Dreesen, T. (2023). *Transforming Education in Kosovo with the Learning Passport - The case of Shkollat.org - Policy Brief*. Gjetur në <https://www.unicef.org/innocenti/reports/transforming-education-kosovo-learning-passport>
- Frailon, J. (2024). *An International Perspective on Digital Literacy - Results from ICILS 2023*. Amsterdam: International Association for the Evaluation of Educational Achievement (IEA). Gjetur në https://www.iea.nl/sites/default/files/2024-11/ICILS_2023_International_Report_0.pdf
- KCDE. (2025). Gjetur në <https://kcde-ks.org/>
- Komisioni Evropian. (2004b). *Economic Reform Programmes of Albania, Bosnia and Herzegovina, Georgia, Kosovo*, Moldova, Montenegro, North Macedonia, Serbia and Türkiye: The Commission's overview & country assessments*. Gjetur në https://economy-finance.ec.europa.eu/publications/2024-economic-reform-programmes_en
- Komisioni Evropian. (2023). *EU Progress Report 2023 - Kosovo*. Gjetur në https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023_en
- Komisioni Evropian. (2024a). *EU Progress Report 2024 - Kosovo*. Gjetur në https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en

- Ministria e Financave. (2024). *Medium-Term Expenditure Framework 2025-2027*. Gjetur në <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/5078e7a8-b123-49e3-bf7e-71031217df5c.pdf>
- Mrdovic, P. (2023). *The role of digitalisation in transforming Western Balkan societies*. Vienna: Österreichische Gesellschaft für Europapolitik (ÖGfE). Gjetur në <https://www.oegfe.at/wp-content/uploads/2000/12/PB-142023.pdf>
- Pireva-Nuçi, K. (2025). *Assessing Digital Competence of K1-12 Teachers in Kosovo: A Study through the Lens of DigCompEdu and TPACK*. *Manuscript submitted for publication*.
- Qeveria e Kosovës. (2023b). *e-Government Strategy of Kosovo 2023–2027*. Gjetur në <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/2700/e-Government%20Strategy%20Kosovo%202023-2027.pdf>
- Qeveria e Kosovës. (2023b). *e-Government Strategy of Kosovo 2023–2027*. Gjetur në <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/2700/e-Government%20Strategy%20Kosovo%202023-2027.pdf>
- Qeveria e Kosovës. (2024). *Reform and Growth Facility for the Western Balkans - Reform Agenda of Kosovo*. Gjetur në <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/10/RGF-Kosovo-Reform-Agenda.pdf>
- RCC. (2021). *Digital skills needs and gaps in the Western Balkans - scope and objectives for a fully-fledged assessment*. Gjetur në <https://www.rcc.int/pubs/129/digital-skills-needs-and-gaps-in-the-western-balkans--scope-and-objectives-for-a-fully-fledged-assessment>
- RCC. (2022). *Western Balkans Digital Economy Society Index – WB DESI 2022 Report*. Gjetur në <https://www.rcc.int/pubs/159/western-balkans-digital-economy-society-index-wb-desi-2022-report>
- RKS. (2012a). Law No. 04/L-109 on Electronic Communications. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2851&langid=2>
- RKS. (2012b). Law No.04/L-094 on Information Society Services. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2811&langid=2>
- RKS. (2013). Law No. 04/I-145 on Information Society Government Bodies. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8669&langid=2>
- RKS. (2021a). Law No. 08/L-022 on Electronic Identification and Trust Services in Electronic Transactions. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51618&langid=2>

- RKS. (2021b). Law No. 08/L-007 on Measures to Reduce the Cost of Deploying High-Speed Electronic Communications Networks. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51135&langid=2>
- RKS. (2023). Law No. 08/L-173 on Cyber Security. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=70933>
- RKS. (2024). *Law No. 08/I -332 on budget appropriations for the Budget of the Republic of Kosovo for year 2025*. Gjetur në <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/c47f8415-0761-4ae3-8ddb-0ae74ac0e9a4.pdf>
- STIKK. (2019). *Internet Penetration and Usage in Kosovo - National Quantitative Survey*. Gjetur në https://stikk.org/wp-content/uploads/2019/11/STIKK_IK_Report_Internet_Penetration_V3-final-1.pdf
- The Foundation House*. (2025). Gjetur në <https://thefoundationhouse.org/>
- UNDP. (2025). *UNDP - Digital Kosovo*. Gjetur në Digital Household Survey: <https://www.undp.org/kosovo/digital>
- UNICEF. (2022). *Digital Learning Landscape in Bosnia and Herzegovina, Kosovo, Montenegro, and North Macedonia*. Gjetur në <https://www.unicef.org/innocenti/reports/digital-learning-landscape-western-balkans>
- World Bank. (2024b). *Republic of Kosovo Implementation Support Mission for Kosovo Digital Economy (KODE) Project (P164188) & Digital analytical support for the Western Balkans Technical Assistance (P502126), October 21-25, 2024, Aide-Mémoire*. Gjetur në <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099122024102027067/pdf/P164188-8d6dad2f-4c38-49f7-a3ee-8c8028a07fb1.pdf>

SHTOJCA 1.

FINANCIMI I POLITIKAVE PËR PËRFSHIRJE DIGJITALE

Burimi i financimit	Përfituesi	Përshkrimi i objektivave	Përfshirja digjitale	Buxheti i përgjithshëm (EUR)	Buxheti i dedikuar për përfshirjen digjitale (EUR)
Bashkimi Evropian (Qeveria e Kosovës, Reformave e 2024)	Qeveria e Kosovës (Agjenda e Reformave e Kosovës)	<p>1) Përmirësimi i infrastrukturës fikse të internetit me brez të gjerë në Rrjete me Kapacitet Shumë të Lartë (VHCN);</p> <p>2) Zhvillimi i infrastrukturës së avancuar që mbështet shërbimet e të dhënave dhe inteligjencën artificiale (AI);</p> <p>3) Marrja e Domenit të Nivelit të Lartë të Kodit të Shtetit të Kosovës (ccTLD);</p> <p>4) Themelimi i një Qendre për Ndarjen dhe Analizën e Informacioneve (ISAC) për përmirësimin e sigurisë kibernetike; 5) Promovimi i shtrirjes së gjerë të infrastrukturës së internetit me brez të gjerë; 6) Shtrirja e infrastrukturës 5G përgjatë korridoreve kryesore të transportit që lidhin Kosovën me vendet fqinje.</p>	Lidhja e përmirësuar digjitale, qasja me brez të gjerë, përmirësimet në sigurinë kibernetike dhe nismat e integritit rajonal kontribuojnë ndjeshëm në përfshirjen digjitale.	40,000,000	Nuk specifikohet
Banka Botërore (Ministria e Financave, 2024)	Qeveria e Kosovës (Projekti i Forcimit të Qeverisjes Digjitale)	Forcimi i qeverisjes digjitale të Kosovës përmes: (1) Transformimit digjital të qeverisë, përfshirë mbështetjen për zhvillimin digjital dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë ndaj rreziqeve digjitale; (2) Transformimi digjital i shërbimeve publike për të ulur barrën administrative dhe për të përshtatur shërbimet me ngjarjet jetësore të qytetarëve; (3) Inovacioni, menaxhimi i ndryshimeve dhe ndërtimi i kapaciteteve, duke përfshirë krijimin e një qendre inovacioni në Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit (ASHI).	Kontribuon në mënyrë indirekte në përfshirjen digjitale duke përmirësuar qasjen në shërbimet publike digjitale dhe duke rritur kapacitetin institucional.	18,600,000	Nuk specifikohet

Burimi i financimit	Përfituesi	Përshkrimi i objektivave	Përfshirja digjitale	Buxheti i përgjithshëm (EUR)	Buxheti i dedikuar për përfshirjen digjitale (EUR)
Banka Botërore (Banka Botërore, 2018)	Ministria e Ekonomisë (Projekti KODE)	Të përmirësohet qasja në internet të shpejtë dhe me cilësi të lartë në rajonet e pazhvilluara dhe të ofrohet trajnim për të rinjtë për t'i fuqizuar ata për të punuar online.	Komponenti i përfshirjes digjitale i Projektit KODE fokusohet në zgjerimin e qasjes në internet me shpejtësi të lartë në zonat e pambuluara sa duhet, veçanërisht në vendbanimet rurale dhe institucionet publike. Ai mbështet bashkëfinancimin për ofruesit privatë për të lidhur komunitetet e pambuluara sa duhet dhe përfshin ndërtimin e kapaciteteve për organet rregullatore për të forcuar mjedisin e politikave dhe atë ligjor. Përveç kësaj, ai prezanton një Sistem Kombëtar të Menaxhimit të Spektrit për të përmirësuar cilësinë e shërbimit mobil dhe për të siguruar përdorim efikas të spektrit, duke nxitur një lidhje digjitale më gjithëpërfshirëse në të gjithë Kosovën.	20,700,000	18,600,000
Buxheti i Kosovës (RKS, 2024)	Ministria e Ekonomisë	Themelimi i Qendrës për Ekselencë Digjitale në Parkun e Inovacionit në Prizren.	Potencial për të mbështetur përfshirjen digjitale përmes zhvillimit të aftësive dhe qasjes në burimet e inovacionit digjital, në varësi të planit të zbatimit.	1,736,528	Nuk specifikohet
Buxheti i Kosovës (RKS, 2024)	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	Investime në infrastrukturën e qeverisjes elektronike, sisteme të ndërveprimit, hardueri, sigurinë kibernetike, rrjetin kompjuterik qeveritar dhe qendrën e rimëkëmbjes.	Kontribuon indirekt në përfshirjen digjitale duke mundësuar shërbime elektronike publike më të qasshme dhe më të sigurta.	23,773,062	Nuk specifikohet
Buxheti i Kosovës (RKS, 2024)	Ministria e Arsimit	Prokurimi i pajisjeve digjitale për institucionet e Arsimit Parauniversitar për të përmirësuar mjediset digjitale të të nxënësve.	Kontribuon drejtpërdrejt në përfshirjen digjitale duke rritur qasjen në mjetet digjitale për nxënësit dhe mësuesit në të gjithë Kosovën.	15,000,000	Nuk specifikohet

SHTOJCA 2. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE TË HULUMTIMIT

TEMA	PRETENDIMET	PËRGJIGJET E DISPONUESHME				
		Ky rezultat nuk është aspak në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është pjesërisht në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është shumë në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është plotësisht në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Vlerësimi nuk është i mundur për shkak të mungesës së hulumtimit ose për arsye të tjera
BARAZIA E QASJES NË INTERNET DHE TEKNOLOGJITË DIGJITALE	Hulumtimi tregon një dallim të konsiderueshme në qasjen në internet dhe në teknologjitë digjitale ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Njerëzit nga zonat rurale shpesh kanë qasje të kufizuar në internet dhe teknologji.	1	2	3	4	5
<p><i>Jepni një shpjegim të shkurtër të përgjigjes suaj. Kur shpjegoni përgjigjen tuaj, sa herë që është e mundur plotësojeni atë me tregues numerikë dhe/ose gjetje të hulumtimeve të tjera në kontekstin tuaj kombëtar.</i></p>		<p>Ky rezultat përputhet shumë me gjetjet e hulumtimit në Kosovë. Disa burime konfirmojnë se, ndonëse Kosova ka mbulim pothuajse universal me internet me brez të gjerë në nivel të familjeve (99%), ekziston një ndarje e qartë urbane-rurale për nga cilësia e infrastrukturës dhe qasjes digjitale. (RCC, 2022). Veçanërisht shkollat në zonat rurale nuk kanë lidhje adekuate të internetit dhe pajisje digjitale, gjë që pengon ndjeshëm si cilësinë e mësimdhënies ashtu edhe rezultatet e të nxënësve (Banka Botërore, 2024a). Hendeku digjital ndërmjet zonave urbane dhe rurale është gjithashtu i dokumentuar, duke ndikuar si në qasje ashtu edhe në infrastrukturë (RCC, 2021) (Komisioni Evropian, 2004b). Intervistat në terren mbështesin këto konstatime, duke nxjerrë në pah boshllëqet e vazhdueshme në besueshmërinë dhe disponueshmërinë e pajisjeve të internetit me brez të gjerë në shkollat dhe komunitetet rurale.</p>				
BARAZIA E QASJES NË INTERNET DHE NË TEKNOLOGJITË DIGJITALE	Hulumtimet tregojnë një ndryshim të rëndësishëm në qasjen në internet dhe teknologjitë digjitale ndërmjet grupeve të ndryshme socioekonomike. Të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, personat me nivele më të ulëta arsimimi, etj., kanë qasje të kufizuar në internet dhe në teknologji.	1	2	3	4	5

TEMA	PRETENDIMET	PËRGJIGJET E DISPONUESHME				
		Ky rezultat nuk është aspak në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është pjesërisht në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është shumë në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është plotësisht në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Vlerësimi nuk është i mundur për shkak të mungesës së hulumtimit ose për arsye të tjera
		<p>Burime të shumta konfirmojnë se individët nga familjet me të ardhura të ulëta, komunitetet etnike të marginalizuara dhe nga zonat rurale kanë qasje të kufizuar dhe aftësi më të ulëta digjitale. Për shembull, vetëm 75% e vajzave rome, ashkali dhe egjiptiane përdorin kompjuterë, krahasuar me 90% të djemve nga të njëjtat komunitete (UNICEF, 2022), që paraqet pabarazi si socioekonomike ashtu edhe gjinore. Në mënyrë të ngjashme, nxënësit nga familjet në gjendje të vështirë ekonomike demonstrojnë kompetencë më të ulët digjitale për shkak të mungesës së qasjes në pajisje dhe internet në shtëpi (Banka Botërore, 2024a). Hendeku digjital thellohet edhe më shumë për shkak të niveleve më të ulëta të kompetencës digjitale tek popullatat në zona rurale, gratë dhe grupet në gjendje të pafavorshme socioekonomike (UNICEF, 2022). ICILS 2023 (Fraillon, 2024) i përforcon më tej këto gjetje duke treguar se nxënësit në Kosovë që kanë gjithmonë qasje në kompjuterë për të kryer detyrat e shkollës marrin mesatarisht 67 pikë më shumë se bashkëmoshatarët e tyre që nuk kanë një qasje të tillë - një nga mangësitë më të mëdha në nivel ndërkombëtar - duke demonstruar se si mjetet e familjes i japin formë rezultateve digjitale. Megjithatë, të dhënat kombëtare mbi të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara mbeten të kufizuara, dhe pengesat specifike të qasjes së tyre nuk janë studiuar ende në mënyrë sistematike.</p>				
AFTËSITË DIGJITALE	Shumë studime tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë (veçanërisht të moshuarit dhe njerëzit me nivel të ulët arsimimi) nuk kanë aftësi bazike digjitale, duke penguar ndjeshëm përdorimin e mjeteve digjitale dhe qasjen në informacione të rëndësishme.	1	2	3	4	5
		<p>Sipas RCC (2022), vetëm 28% e personave në Kosovë kanë të paktën aftësi digjitale bazike, shumë nën mesataren e BE-së prej 54%, ndërsa 14% posedojnë aftësi mbi ato bazike. Përveç kësaj, RCC (2021) po ashtu thekson se të moshuarit dhe njerëzit me arritje më të ulët arsimore tregojnë gatishmëri digjitale veçanërisht të kufizuar. ICILS 2023 e konfirmon këtë gjendje tek nxënësit: vetëm 30% e nxënësve të klasës së 8-të në Kosovë arritën Nivelin 2 ose më lart në njohuritë kompjuterike dhe informatike, krahasuar me 49% në nivel ndërkombëtar, duke treguar kompetenca shumë të kufizuara (Fraillon, 2024). Ngjashëm, studimi i Pireva-Nuçi et al. (2025) mbi mësimdhënësit konstatoi kompetencë digjitale të pabarabartë, veçanërisht në integrimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe vlerësim, pavarësisht besimit për përdorimin e mjeteve digjitale. Këto gjetje së bashku tregojnë se aftësitë e kufizuara digjitale janë një pengesë që është e pranishme jo vetëm tek popullsia e cënueshme, por edhe në sektorë të ndryshëm të shoqërisë, përfshirë profesionistët e arsimit.</p>				

TEMA	PRETENDIMET	PËRGJIGJET E DISPONUESHME				Vlerësimi nuk është i mundur për shkak të mungesës së hulumtimit ose për arsye të tjera
		Ky rezultat nuk është aspak në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është pjesërisht në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është shumë në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është plotësisht në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	
NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19	Pandemia përshpejtoi kalimin në shërbime digjitale në arsim, punë dhe në jetën e përditshme. Hulumtimet tregojnë se shumë njerëz janë bërë më të vetëdijshëm për rëndësinë e aftësive dhe mjeteve digjitale gjatë kësaj periudhe, por ende ka dallime të mëdha në kapacitetin për t'u përshtatur.	1	2	3	4	5
<i>Jepni një shpjegim të shkurtër të përgjigjes suaj. Kur shpjegoni përgjigjen tuaj, sa herë që është e mundur plotësojeni atë me tregues numerikë dhe/ose gjetje të hulumtimeve të tjera në kontekstin tuaj kombëtar.</i>		Banka Botërore (2024) dhe UNICEF (2022) dokumentojnë qartë se si pandemia COVID-19 përshpejtoi kalimin në shërbime digjitale në arsim, se si ajo nxiti përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve (p.sh., trajnimin e mësimdhënësve) dhe nxori në pah pabarazitë digjitale, veçanërisht për grupet e margjinalizuara. Përmbledhja e politikave të UNICEF-it mbi Shkollat.org tregon më tej se, ndonëse platforma mbështeti të nxënit gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e aftësive të mësimdhënësve, sfidat në infrastrukturë dhe qasje të barabartë vazhduan, duke shtuar pabarazitë pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimit për aftësitë digjitale (Cárceles Martínez-Lozano & Dreesen, 2023)				
BESIMI NË TEKNOLOGJI	Hulumtimet tregojnë se shqetësimet e qytetarëve në lidhje me privatësinë dhe sigurinë e të dhënave kur përdorin shërbimet digjitale mund të ndikojnë negativisht në gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar në botën digjitale.	1	2	3	4	5
<i>Jepni një shpjegim të shkurtër të përgjigjes suaj. Kur shpjegoni përgjigjen tuaj, sa herë që është e mundur, plotësojeni atë me tregues numerikë dhe/ose gjetje të hulumtimeve të tjera në kontekstin tuaj kombëtar.</i>		Raporti i Progresit i BE-së (Komisioni Evropian, 2024a) nënvizon sfidat e vazhdueshme që kanë të bëjnë me sigurinë kibernetike dhe besimin digjital në Kosovë. Ai thekson domosdoshmërinë e rritjes së përafrimit me standardet e BE-së, veçanërisht me Direktivën NIS2 dhe Kornizën e Identitetit Digjital të BE-së, dhe thekson urgjencën e zhvillimit të politikave të forta për përdorim më të sigurt të internetit, veçanërisht për të mbrojtur fëmijët në internet. Edhe pse raporti nuk i mat në mënyrë të qartë shqetësimet e qytetarëve, këto mangësi të theksuara të sigurisë kibernetike dhe vonesat në përafrimin me rregulloret gjithëpërfshirëse të BE-së nënkuptojnë fuqishëm një shqetësim të mundshëm publik në lidhje me privatësinë e të dhënave dhe sigurinë digjitale. Për më tepër, dokumenti i politikave rajonale (Mrdović, 2023) konfirmon një mungesë të përgjithshme të besimit në shërbimet digjitale në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përforcuar vlefshmërinë e këtij shqetësimi brenda kontekstit të Kosovës.				

TEMA	PRETENDIMET	PËRGJIGJET E DISPONUESHME				
		Ky rezultat nuk është aspak në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është pjesërisht në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është shumë në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është plotësisht në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Vlerësimi nuk është i mundur për shkak të mungesës së hulumtimit ose për arsye të tjera
INICIATIVAT E TRAJNIMIT	Ekziston një numër në rritje i programeve dhe iniciativave që përqendrohen në përmirësimin e njohurive digjitale, veçanërisht në mesin e grupeve të cenueshme, siç janë të moshuarit, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara. Hulumtimet shpesh theksojnë nevojën për arsim dhe aftësim të vazhdueshëm në këtë fushë, bashkë me nevojën për të pasuruar ofertën.	1	2	3	4	5
<p><i>Jepni një shpjegim të shkurtër të përgjigjes suaj. Kur shpjegoni përgjigjen tuaj, sa herë që është e mundur plotësojeni atë me tregues numerikë dhe/ose gjetje të hulumtimeve të tjera në kontekstin tuaj kombëtar.</i></p>		<p>Raporte të shumta tregojnë se Kosova ka nisur disa programe të edukimit digjital, disa prej të cilave synojnë posaçërisht grupet e cenueshme, megjithëse këto mbeten të kufizuara për nga fushëveprimi dhe mbulimi. Sipas UNICEF-it (2022), gjatë pandemisë COVID-19 u bënë përpjekje të synuara për të trajnuar 2,500 mësimdhënës në aftësi digjitale dhe për të siguruar pajisje dhe lidhje për të rinjtë e margjinalizuar, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara. RCC (2021) thekson edhe programet e mbështetura nga donatorët të fokusuara në përmirësimin e edukimit digjital të popullatave rurale dhe grave, kryesisht përmes qendrave të trajnimit për TIK, qendrat e arsimit profesional dhe të inovacionit. Megjithatë, intervistat në terren tregojnë se nisma të tilla janë të fragmentuara dhe kryesisht të paqëndrueshme, pa ndonjë program sistematik shtetëror të edukimit digjital për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara ose popullatat rurale me të ardhura të ulëta. Përfaqësuesit e OSHC-ve theksuan se, ndonëse shoqëria civile ka realizuar projekte të rëndësishme - siç është trajnimi për aftësi digjitale për vajzat dhe të rinjtë romë, ashkali dhe egjiptianë - këto mbeten të izoluar dhe të varura nga financimi i jashtëm.</p>				
SFIDAT NË ARSIM	Hulumtimet tregojnë se sistemi arsimor në vendin tonë ende nuk është përshtatur plotësisht me të nxënërit digjital. Nevojiten investime shtesë në infrastrukturë dhe trajnim të mësimdhënësve për të mundësuar integrimin e mjeteve digjitale në procesin mësimor.	1	2	3	4	5

TEMA	PRETENDIMET	PËRGJIGJET E DISPONUESHME				
		Ky rezultat nuk është aspak në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është pjesërisht në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është shumë në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Ky rezultat është plotësisht në përputhje me gjetjet e hulumtimit në Kosovë.	Vlerësimi nuk është i mundur për shkak të mungesës së hulumtimit ose për arsye të tjera
		<p>Raporte të shumta - përfshirë ato të Bankës Botërore (2024), UNICEF-it (2022) dhe RCC-së (2021) ofrojnë prova të qarta se sistemi arsimor i Kosovës nuk është përshtatur ende plotësisht për të nxënëit digjital. Sipas vlerësimit të Bankës Botërore, shkollave në zonat rurale shpesh u mungon infrastruktura digjitale bazë dhe shumë mësimdhënës kanë aftësi të kufizuara digjitale, duke penguar kështu ndjeshëm pedagogjinë digjitale efektive. Në mënyrë të ngjashme, UNICEF (2022) nënvizon kapacitetin e pamjaftueshëm të TIK-ut në shkolla dhe përgatitjen e kufizuar të mësimdhënësve si pengesa kryesore për përfshirjen digjitale. Edhe pse janë zhvilluar platforma të ngjashme si Shkollat.org për të mbështetur arsimin digjital, ato kërkojnë investime të vazhdueshme në trajnimin e mësimdhënësve dhe në përmirësimet e infrastrukturës për t'u integruar në mënyrë efektive në praktikën në klasë. RCC (2021) po ashtu ka vërejtur një mospërputhje ndërmjet zhvillimit të aftësive digjitale në arsim dhe nevojave të tregut të punës, duke rritur nevojën për përmirësime sistemike. Këto mangësi strukturore u përmendën edhe në intervistat në terren, ku përfaqësuesit e shkollave vunë në dukje mungesën e mbështetjes teknike, qasjen e dobët në internet dhe përshtatjen e pamjaftueshme të përmbajtjes digjitale. Studimi i Pireva-Nuçi (2025) zbulon më tej se, ndonëse mësimdhënësit janë të sigurt në përdorimin e mjeteve digjitale për detyrat administrative dhe angazhimin e nxënësve, ata kanë vështirësi në integrimin e tyre në proceset e mësimdhënies dhe vlerësimit, duke vënë në pah nevojën për trajnim digjital më të orientuar drejt pedagogjisë.</p>				
MBËSHTETJA POLITIKE DHE INSTITUCIONALE	Hulumtimet tregojnë nevojën për politika dhe strategji më të forta në nivel kombëtar për të përmirësuar përfshirjen digjitale. Ekzistojnë iniciativa në nivel qeveritar, por nevojitet më shumë koordinim dhe resurse.	1	2	3	4	5
		<p>Raporte të shumta konfirmojnë se, ndonëse Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përfshirjes digjitale - siç është hartimi i Agjendës Digjitale 2030, Drafti i Strategjisë për Digjitalizimin e Arsimit dhe integrimi i aftësive digjitale në strategji më të gjera kombëtare (Banka Botërore, 2024; RCC, 2021), ende ka një mungesë të dukshme të koordinimit sistematik, mekanizmave të zbatimit dhe resurseve adekuate. Vlerësimi i RCC-së (2021) thekson se, megjithëse aftësitë digjitale dhe ekonomia digjitale janë prioritete të njohura të politikave, koordinimi në nivel vendi mbetet i dobët dhe financimi është i kufizuar, shpesh duke u bazuar në mbështetjen e donatorëve. Në mënyrë të ngjashme, raporti i UNICEF-it (2022) thekson mungesën e udhëzimeve gjithëpërfshirëse kombëtare për shkollat, mësimdhënësit dhe prindërit, dhe thekson nevojën për politika më të forta dhe gjithëpërfshirëse. Gjatë intervistave në terren, palët e interesuara e përshkruan zbatimin e politikave si të fragmentuar, me bashkëpunim minimal ndërmjet ministrive kryesore. Për shembull, Ministria e Ekonomisë ka përparuar me zgjerimin e internetit me brez të gjerë në kuadër të projektit KODE, megjithatë Ministria e Arsimit ende nuk i ka shpërndarë fondet e alokuara për pajisjet digjitale të shkollave. Aktorët e shoqërisë civile po ashtu theksuan mungesën e mekanizmave të strukturuar të angazhimit me qeverinë dhe vëmendjen e kufizuar ndaj grupeve të cenueshme në politikat e përfshirjes digjitale.</p>				

SHTOJCA 3.

INICIATIVA TË ZGJEDHURA PËR PËRFSHIRJEN DIGJITALE

Emri i veprimit	Org./inst. zbatues	Partnerët (nëse ka)	Përshkrimi i veprimit (objektivat/qëllimet/aktivitetet)	Grupet e synuara/përfituesit	Rezultatet	Buxheti (EUR)
Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE)	Ministria e Ekonomisë	Banka Botërore	Përmirësimi i qasjes në internet me brez të gjerë me shpejtësi të lartë në zonat e pambuluara sa duhet, rritja e lidhjes së shkollave, trajnimi i të rinjve për aftësi digjitale dhe forcimi i mjedisit që mundëson shërbimet digjitale. Aktivitetet përfshijnë shtrirjen e internetit me brez të gjerë në fshatrat në zonat rurale, instalimet elektrike të brendshme në shkolla, infrastrukturën e gatshme për 5G, programin e trajnimit YOU për punë online dhe funksionalizimin e Rrjetit të Kosovës për Huluntim dhe Edukim (KREN).	Qytetarët në zonat rurale, shkollat fillore dhe të mesme, të rinjtë, institucionet publike, operatorët e rrjetit mobil.	Interneti me brez të gjerë është shtrirë në 203 fshatra; 197 shkolla janë lidhur me instalime të brendshme të avancuara dhe me rrjetin kryesor të KREN; 2,190 të rinj janë trajnuar (përfshirë 881 gra) me nivel të lartë kënaqshmërie dhe rezultate premtuese për punësim; KREN u krijua si rrjet kombëtar për huluntim dhe edukim në Kosovë, duke siguruar lidhje të qëndrueshme digjitale për akademinë.	20.7 mil
eKosova	Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (ASHI)	Njësitë organizative të qeverisjes qendrore dhe lokale, bizneset	E lansuar në vitin 2020, eKosova ofron qasje të centralizuara online në 230 shërbime qeveritare (certifikata të gjendjes civile, pagesë të tatimit, dokumente pronësore, gjoba trafik, aplikime për përfitime, fatura shërbimesh). Objektivat përfshijnë digjitalizimin e të 650 shërbimeve shtetërore, përmirësimin e ndërveprimeve të shërbimeve lokale përmes zgjerimit me komponentin e-Komuna, përmirësimin e qasjes (duke përfshirë edhe përdoruesit me shikim të kufizuar) dhe krijimin e pikave fizike të ndihmës "One-Stop-Shop" për grupet e përjashtuara në aspektin digjital. Aktivitetet e ardhshme përfshijnë edhe integrimin e tipareve të avancuara të qasjes (p.sh., njohjen e zërit) dhe fushata të ndërgjegjësimit për të promovuar shërbimet digjitale tek popullatat e pambuluara sa duhet.	Popullsia e përgjithshme, komunitat, bizneset.	Mbi 1 milion përdorues të regjistruar deri në vitin 2024, duke përmirësuar ndjeshëm angazhimin e qytetarëve dhe ndërveprimin digjital me shërbimet qeveritare; lansimi me sukses i zgjerimit me komponentin e-Komuna që lehtëson ndërveprimet me qeverisjen vendore.	ASHI ka një buxhet prej 23.77 milionë eurosh. Buxheti për portalin eKosovan nuk është specifikuar.

Emri i veprimit	Org./inst. zbatues	Partnerët (nëse ka)	Përshkrimi i veprimit (objektivat/qëllimet/aktivitetet)	Grupet e synuara/përfituesit	Rezultatet	Buxheti (EUR)
Shkollat.org – Platformë Kombëtare e të Nxënës Digjital	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)	UNICEF	E lansuar në vitin 2021, platforma Shkollat.org është platforma kombëtare e të nxënës digjital në Kosovë, duke ofruar arkivin më të madh të përmbajtjeve video të përshtatura me kurrikulën, të integruara me mjete si Microsoft Teams dhe Office 365. Platforma mbështet mësimin në distancë dhe të kombinuar, dhe synon të promovojë arsimin digjital të barabartë, gjithëpërfshirës dhe të përqendruar te nxënësi. Aktivitetet fokusohen në zhvillimin e përmbajtjes, përmirësimin e aftësive të mësimitdhënësve, përmirësimin e lidhjes së shkollave me internet dhe koordinimin institucional.	Nxënësit dhe mësimitdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme, veçanërisht në komunat më pak të mbështetura.	Platforma është në përdorim në të gjithë vendin; është rritur angazhimi i mësimitdhënësve dhe qasja në materialet mësimore; mbështet integrimin e të nxënës digjital në arsimin formal.	N/A

SHTOJCA 4.

LISTA E PALËVE TË INTERESUARA QË JANË KONSULTUAR

Intervista individuale

1. **Vesa Batalli** – Drejtoreshë e Programit, Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VoRAE)
2. **Granit Brajshori** – Menaxher i Projektit, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
3. **Arben Shala** – Menaxher i Programit, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)
4. **Gresa Stublla** – Menaxhere e Projektit, Handikos
5. **Kozeta Imami** – Udhëheqëse e Programit për Arsim, UNICEF
6. **Krenare Pireva-Nuçi** – Profesor Asistent, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës
7. **Antigona Uka** – Drejtoreshë Ekzekutive, Qendra e Kosovës për Arsim Digjital (KCDE)
8. **Genc Hamzaj** – UD/Drejtor, Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (ASHI)
9. **Agim Kukaj** – Drejtor i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), Ministria e Ekonomisë
10. **Bekim Kasumi** – Drejtor Ekzekutiv, Shoqata Profesionale e Informaticientëve të Kosovës (SHPIK)
11. **Lulezon Jagxhiu** – Këshilltar i Kryeministrit për Teknologjinë e Informacionit, Zyra e Kryeministrit

Grupet e fokusit

1. **Grupi i fokusit me studentë romë, ashkalinj dhe egjiptianë** – 9 pjesëmarrës
2. **Grupi i fokusit me stafin arsimor** – 4 pjesëmarrës



<https://www.facebook.com/DigitalInclusionInitiative>



diiproject.net